

Orig.english / vers. Albanian
Unofficial, unrevised translation



COUNCIL OF EUROPE CONSEIL DE L'EUROPE

Seria e traktateve evropiane - n° 78

KONVENTA EVROPIANE E SIGURIMEVE SHOQËRORE

Paris, 14.XII.1972

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkruese të kësaj Konvente,

Duke patur parasysh se synimi i Këshillit të Evropës është të realizojë një bashkim më të ngushtë midis anëtarëve të tij, konkretisht për të mbështetur përparimin e tyre shoqëror ;

Duke patur parasysh se bashkërendimi shumëpalësh në fushën e legjislacionit të sigurimeve shoqërore është një nga mjetet për të realizuar këtë objektiv ;

Duke patur parasysh se Kodi evropian i sigurimeve shoqërore, i çelur për nënshkrim më 16 prill 1964, përcakton, në nenin 73 të tij, që Palët kontraktuese në Kod do të përpiqen të zgjidhin, me anë të një instrumenti të posaçëm, çështjet që kanë të bëjnë me sigurimet shoqërore për të huajt dhe refugjatët, konkretisht për sa i përket trajtimit të tyre të barabartë si vendasit dhe ruajtjes të të drejtave që kanë arritur apo janë duke arritur ;

Duke pohuar parimin e trajtimit të barabartë të shtetasve të Palëve kontraktuese, të refugjatëve dhe personave pa shtetësi mbi bazën e legjislacionit të sigurimeve shoqërore të çdo Pale kontraktuese, si dhe parimin e ruajtjes së përfitimeve të ardhura nga legjislacionet e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga zhvendosjet e personave të marrë në mbrojtje në territoret e Palëve kontraktuese, parime nga të cilat marrin shkas, nga ana tjetër, jo vetëm disa dispozita të Kartës sociale evropiane, por edhe shumë konventa të Organizatës ndërkombëtare të punës,

Janë marrë vesh për sa më poshtë :

Pjesa I – Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

- a termi « Palë kontraktuese » përcakton çdo shtet që ka depozituar një instrument ratifikimi, pranimi apo aderimi, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 75 apo të nenit 77 ;
- b termat « territor i një Pale kontraktuese » dhe « shtetas i një Pale kontraktuese » janë përkufizuar në Shtojcën I ; çdo Palë kontraktuese do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë Shtojcës I ;
- c termi « legjislacion » përcakton ligjet, rregullat dhe dispozitat statutorë që kanë hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit të kësaj Konvente apo që do hyjnë më pas në fuqi në krejt territorin e çdo Pale kontraktuese apo në një pjesë të çfarëdoshme të këtij territori dhe që kanë të bëjnë me degët dhe sistemet e sigurimeve shoqërore të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 2 ;

- d termi « konventë e sigurimeve shoqërore » përcakton çdo instrument dypalësh a shumëpalësh që lidh a do të lidhë veçanërisht dy a më shumë Palë kontraktuese, si dhe çdo instrument shumëpalësh që lidh a do të lidhë të paktën dy Palë kontraktuese dhe një shtet tjetër apo shumë shtete të tjera në fushën e sigurimeve shoqërore, për krejt degët dhe sistemet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 2 apo për një pjesë të tyre, po ashtu edhe marrëveshjet e çdo lloji të arritura në kuadrin e këtyre instrumenteve ;
- e termi « autoritet kompetent » përcakton ministrin, ministrat apo autoritetin përgjegjës prej të cilit varen sistemet e sigurimeve shoqërore, në krejt territorin e çdo Pale kontraktuese apo në një pjesë të çfarëdoshme të këtij territori ;
- f termi « institucion » përcakton organizmin apo autoritetin e ngarkuar për të zbatuar tërësisht apo pjesërisht legjislacionin e çdo Pale kontraktuese ;
- g termi « institucion kompetent » përcakton :
- i në rastin e një procedure sigurimesh shoqërore, qoftë institucionin në të cilin është përfshirë i interesuari në çastin e kërkesës për të ardhura, qoftë institucionin me anë të të cilit ai ka të drejtë për të ardhura apo do të kishte të drejtë për të ardhura nëse do banonte në territorin e Palës kontraktuese ku ndodhet ky institucion, qoftë institucionin e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë ;
- ii në rastin e një procedure e ndryshme nga ajo e sigurimeve shoqërore apo të një procedure pensionesh familjare, institucionin e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë ;
- iii në rastin e një procedure që ka të bëjë me detyrimet e punëdhënësit lidhur me të ardhurat e përmendura në paragrafin 1 të nenit 2, qoftë punëdhënësin apo siguruesin që vepron në emër të tij, qoftë, në mungesë, organizmin apo autoritetin e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë ;
- h termi « shtet kompetent » përcakton Palën kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet institucioni kompetent ;
- i termi « banim » do të thotë qëndrim i zakonshëm ;
- j termi « qëndrim » do të thotë qëndrim i përkohshëm ;
- k termi « institucion i vendbanimit » përcakton institucionin e autorizuar për dhënie të ardhurash në vendin ku banon i interesuari, sipas legjislacionit në fuqi të Palës kontraktuese që zbaton ky institucion apo, nëse një institucion i tillë nuk ekziston, institucionin e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë ;
- l termi « institucion i vendqëndrimit » përcakton institucionin e autorizuar për dhënie të ardhurash në vendin ku qëndron përkohësisht i interesuari, sipas legjislacionit në fuqi të Palës kontraktuese që zbaton ky institucion apo, nëse një institucion i tillë nuk ekziston, institucionin e përcaktuar nga autoriteti kompetent i Palës kontraktuese në fjalë ;
- m termi « punonjës » përcakton një punonjës me pagë apo të pavarur, si dhe çdo person tjetër që pranohet nga legjislacioni i Palës kontraktuese në fjalë, mjaft që ky person të mos jetë i përcaktuar ndryshe nga kjo Konventë ;

Unofficial, unrevised translation

- n termi « punonjës kufitar » përcakton një punonjës me pagë që është punësuar në territorin e një Pale kontraktuese dhe banon në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, ku zakonisht kthehet çdo ditë apo të paktën një herë në javë ; megjithatë,
- i punonjësi kufitar i punësuar në territorin e një Pale kontraktuese në një ndërmarrje nga e cila varet normalisht, kur shkëputet nga kjo ndërmarrje jashtë zonës kufitare, qoftë në territorin e së njëjtës Palë, qoftë në territorin e Palës tjetër kontraktuese, ruan për njëfarë kohe, që nuk i kalon katër muajt, cilësinë e punonjësit kufitar gjatë periudhës së shkëputjes së tij, gjithnjë brenda kufirit të katër muajve ;
- ii punonjësi kufitar i punësuar në territorin e një Pale kontraktuese në një ndërmarrje nga e cila varet normalisht, kur shkëputet nga kjo ndërmarrje jashtë zonës kufitare, qoftë në territorin e së njëjtës Palë, qoftë në territorin e Palës tjetër kontraktuese, ruan për njëfarë kohe, që nuk i kalon katër muajt, cilësinë e punonjësit kufitar gjatë periudhës së shkëputjes së tij, gjithnjë brenda kufirit të katër muajve ;
- o termi « refugjatë » ka kuptimin që i është dhënë në nenin e parë, seksioni A, të Konventës mbi statusin e refugjatit, nënshkruar në Gjenevë më 28 korrik 1951 dhe në paragrafin 2 të nenit të parë të Protokollit mbi statusin e refugjatit, të 31 janarit 1967, pa kurrfarë kufizimi gjeografik ;
- p termi « person pa shtetësi » ka kuptimin që i është dhënë në nenin e parë të Konventës mbi statusin e personave pa shtetësi, hartuar në Nju Jork më 28 shtator 1954 ;
- q termi « anëtarët e familjes » përcakton personat e njohur a të pranuar si të tillë, apo të përcaktuar si pjesëtarë të një vatre të përbashkët, nëpërmjet legjislacionit që zbaton institucioni i ngarkuar për dhënie të ardhurash, apo në rastet e përmendura në nënparagrafët a dhe c të paragrafit 1 të nenit 21 dhe në paragrafin 6 të nenit 24, nëpërmjet legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ata banojnë ; megjithatë, nëse këto legjislacione konsiderojnë si pjesëtarë të familjes apo të vatrës së përbashkët vetëm personat që jetojnë në një shtëpi me të interesuarin, ky kusht konsiderohet i plotësuar kur personat për të cilët bëhet fjalë janë kryesisht në ngarkim të të interesuarit ;
- r termi « pasjetuesit » përcakton personat që njihen a pranohen si të tillë nga legjislacioni në bazë të të cilit jepen të ardhurat ; megjithatë, nëse ky legjislacion konsideron si pasjetues vetëm ata që jetonin në një vatrë me personin e vdekur, ky kusht njihet i plotësuar kur personat për të cilët bëhet fjalë ishin kryesisht në ngarkim të personit të vdekur ;
- s termi « periudhë sigurimi » përcakton periudhat e kontributeve, punësimit, veprimtarisë profesionale apo të banimit që njihen a pranohen si periudha sigurimi nga legjislacioni në bazë të të cilit ato janë realizuar, si dhe të gjitha periudhat e ngjashme kur njihen nga ky legjislacion si të barasvlefshme me periudhat e sigurimit ;
- t termat « periudhë punësimi » dhe « periudhë veprimtarie profesionale » përcaktojnë periudhat e njohura apo të pranura si të tilla nga legjislacioni në bazë të të cilit ato janë realizuar, si dhe të gjitha periudhat e ngjashme kur njihen nga ky legjislacion si të barasvlefshme me periudhat e punësimit apo të veprimtarisë profesionale ;
- u termi « periudha banimi » përcakton periudhat e njohura a të pranura si të tilla nga legjislacioni në bazë të të cilit ato janë realizuar;

- v termat « të ardhura », « pensione », « renta » përcaktojnë të gjitha të ardhurat, pensionet, rentat, përfshirë edhe tërë komponentët në ngarkim të fondeve publike dhe krejt shtesat, pagesat rivlerësuese apo pagesat suplementare, mjaft që ato të mos jenë të përcaktuara ndryshe nga kjo Konventë, si dhe të ardhurat që paracaktohen për të ruajtur apo përmirësuar aftësinë përfituese, të ardhurat si kapital që mund të mbahen për pensione a renta dhe derdhjet që mund të bëhen në rast nevoje për rimbursim të kontributeve ;
- w termi « pagesë për familje » përcakton të ardhurat periodike në para që jepen në bazë të numrit dhe moshës së fëmijëve ; termi « të ardhurat për familje » përcakton të gjitha të ardhurat që jepen në natyrë apo në para për të kompensuar kostot familjare, veç shpërblimeve të veçanta për lindje, përjashtuar posaçërisht në Shtojcën II ; çdo Palë kontraktuese e interesuar do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë Shtojcës II për sa i përket shpërblimeve të veçanta për lindje të parashikuara nga legjislacioni i saj ;
- x termi « pagesë për vdekje » përcakton çdo shumë të derdhur një herë në rast vdekjeje, pa cënuar fondet si kapital të përcaktuara në nënparagrafin v të këtij neni ;
- y termi « me karakter kontributiv » zbatohet për ato të ardhura, dhënia e të cilave varet ose nga një pjesëmarrje financiare e drejtpërdrejtë e personave të vënë në mbrojtje apo e punëdhënësit të tyre, ose nga një gjendje e caktuar stazhi profesional, si dhe për legjislacionet apo sistemet që japin të ardhura të tilla ; të ardhurat, dhënia e të cilave nuk varet as nga një pjesëmarrje financiare e drejtpërdrejtë e personave të vënë në mbrojtje apo e punëdhënësit të tyre, as nga një gjendje e caktuar stazhi profesional quhen « me karakter jo kontributiv », si dhe legjislacionet apo sistemet që japin ekskluzivisht të ardhura të tilla ;
- z termi « të ardhura të dhëna sipas sistemeve të ndërmjeme » përcakton qoftë të ardhurat që u jepen personave që kanë kaluar njëfarë moshe në çastin e hyrjes në fuqi të legjislacionit të zbatueshëm, qoftë të ardhurat që jepen për gjendje të ndërmjeme, duke pasur parasysh ngjarje të caktuara që kanë ndodhur apo periudha të realizuara jashtë kufijëve aktualë të territorit të një Pale kontraktuese.

Neni 2

- 1 Kjo Konventë zbatohet për të gjitha legjislacionet, mbi bazën e të cilave veprojnë degët e sigurimeve shoqërore që kanë të bëjnë me :
 - a të ardhurat për sëmundje dhe për barrë lindje ;
 - b të ardhurat për invaliditet ;
 - c të ardhurat për pleqëri ;
 - d të ardhurat për pasjetuesit ;
 - e të ardhurat për aksident në punë dhe për sëmundje profesionale ;
 - f pagesat për vdekje ;
 - g të ardhurat për papunësi ;
 - h të ardhurat për familje.

Unofficial, unrevised translation

- 2 Kjo Konventë është e zbatueshme për sisteme të përgjithshme sigurimesh shoqërore dhe për sisteme të veçanta, me karakter kontributiv ose jo kontributiv, si dhe për sisteme që kanë të bëjnë me detyrimet e punëdhënësit lidhur me të ardhurat e përmendura në paragrafin e mësipërm. Marrëveshje dypalëshe a shumëpalëshe midis dy apo më shumë Palëve kontraktuese do të përcaktojnë, për aq sa është e mundur, kushtet në të cilat Konventa do të jetë e zbatueshme për sistemet e krijuara mbi bazën e marrëveshjeve kolektive të bëra të detyrueshme me vendim të pushteteve publike.
- 3 Për sa i përket legjislacioneve lidhur me njerëzit e detit, dispozitat e Pjesës III të kësaj Konvente nuk çënojnë dispozitat ligjore të asnjë Pale kontraktuese lidhur me detyrimet e armatorit, i cili konsiderohet si punëdhënës për zbatimin e Konventës.
- 4 Kjo Konventë nuk zbatohet as për asistencë shoqërore e mjekësore, as për sisteme të ardhurash në favor të viktimave të luftës apo të pasojave të saj, as për sisteme të veçanta për funksionarë apo persona të trajtuar si të tillë.
- 5 Kjo Konventë nuk zbatohet për legjislacione që synojnë të vënë në fuqi një konventë sigurimesh shoqërore arritur midis një Pale kontraktuese dhe një a më shumë shteteve të tjera.

Neni 3

- 1 Shtojca II përmend, për çdo Palë kontraktuese, legjislacionet dhe sistemet e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 2.
- 2 Çdo Palë kontraktuese do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë Shtojcës II pas miratimit të një legjislacioni të ri. Ky notifikim do të bëhet brenda tre muajve nga data e shpalljes së këtij legjislacioni apo, nëse ky legjislacion shpallet para datës së ratifikimit të kësaj Konvente, ditën e ratifikimit të saj.

Neni 4

- 1 Dispozitat e kësaj Konvente do të zbatohen :
 - a për personat që janë apo kanë qenë objekt i legjislacionit të njëjës Palë a të shumë Palëve kontraktuese dhe që janë shtetas të një Pale kontraktuese, apo për refugjatët a personat pa atdhe që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese, si dhe për anëtarët e familjeve të tyre dhe pasjetuesit e tyre ;
 - b për pasjetuesit e personave që kanë qenë objekt i legjislacionit të njëjës Palë a të shumë Palëve kontraktuese, pavarësisht nga shtetësia e këtyre personave, kur këta pasjetues janë shtetas të një Pale kontraktuese, apo për refugjatët a personat pa atdhe që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese ;
 - c pa çenuar dispozitat e paragrafit 4 të nenit 2, për funksionarët dhe personat e trajtuar si të tillë nga legjislacioni i një Pale kontraktuese, për aq kohë sa ata janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale për të cilën gjen zbatim kjo Konventë.

Unofficial, unrevised translation

- 2 Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit c të paragrafit të mësipërm, nuk përfitojnë nga dispozitat e kësaj Konvente kategoritë e personave – të ndryshëm nga anëtarët e personelit të misioneve diplomatike apo posteve konsullore dhe nga personat e punësuar në shërbim privat të zyrtarëve të misioneve apo posteve të tilla – për të cilët Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike dhe Konventa e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore parashikojnë përjashtimin nga dispozitat e sigurimeve shoqërore në fuqi në shtetin pritës.

Neni 5

- 1 Në vartësi të dispozitave të nenit 6, kjo Konventë zëvendëson, për personat ndaj të cilëve ajo gjen zbatim, çdo konventë sigurimesh shoqërore që lidh :
- a dy a më shumë Palë kontraktuese vetëm midis tyre ;
 - b të paktën dy Palë kontraktuese dhe një a më shumë shtete të tjera, kur është fjala për raste, zgjidhja e të cilave nuk kërkon ndërhyrje nga asnjë institucion i ndonjë prej këtyre shteteve.
- 2 Megjithatë, kur zbatimi i disa dispozitave të kësaj Konvente varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe, dispozitat përkatëse të konventave të sigurimeve shoqërore që përmenden në nënparagrafët a dhe b të paragrafit të mësipërm mbeten të zbatueshme deri në hyrjen në fuqi të këtyre marrëveshjeve.

Neni 6

- 1 Dispozitat e kësaj Konvente nuk çenojnë detyrimet që rrjedhin nga një konventë e çfarëdoshme miratuar nga Konferenca Ndërkombëtare e Punës.
- 2 Kjo Konventë nuk çënon dispozitat lidhur me sigurimet shoqërore të Traktatit të 25 marsit 1957 për krijimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane apo të marrëveshjeve shoqëruuese të parashikuara nga ky Traktat, as masat zbatuese të këtyre dispozitave.
- 3 Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të nenit 5, dy a më shumë Palë kontraktuese mund të mbajnë në fuqi me marrëveshje të përbashkët, për aq sa u takon, dispozitat e konventave të sigurimeve shoqërore nëpërmjet të cilave ato janë të lidhura, duke i përmendur në Shtojcën III apo, në rastin e dispozitave që kanë të bëjnë me modalitetet zbatuese të këtyre konventave, në Shtojcën e Marrëveshjes plotësuese për zbatimin e kësaj Konvente.
- 4 Megjithatë, kjo Konventë do të zbatohet në të gjitha rastet për zgjidhjen e të cilave kërkohet ndërhyrja e institucionit të një Palë kontraktuese e ndryshme nga ato që janë të lidhura nëpërmjet dispozitave të përmendura në paragrafin 2 apo në paragrafin 3 të këtij neni, si dhe, nga ana tjetër, në rastin e personave të cilët kanë të drejtë të përfitojnë nga Konventa dhe për të cilët këto dispozita nuk janë të zbatueshme ekskluzivisht për ta.
- 5 Dy a më shumë Palë kontraktuese të lidhura nëpërmjet dispozitave të përmendura në Shtojcën III mund të paraqesin në këtë Shtojcë, me marrëveshje të përbashkët, për aq sa u takon, amendamentet përkatëse, duke i notifikuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81.

Neni 7

- 1 Dy a më shumë Palë kontraktuese mund të përfundojnë midis tyre, për aq sa e kanë të nevojshme, marrëveshje sigurimesh shoqërore të mbështetura mbi parimet e kësaj Konvente.
- 2 Çdo Palë kontraktuese do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo konventë që do të arrihet në bazë të paragrafit të mësipërm, si dhe çdo ndryshim apo denoncim të mëpasshëm që do t'i bëjë një konvente të tillë. Ky notifikim do të bëhet brenda tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi e konventës në fjalë apo e ndryshimit të saj, apo nga dita kur bëhet i efektshëm denoncimi i saj.

Neni 8

- 1 Pa rënë në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente, personat të cilët banojnë në territorin e një Pale kontraktuese dhe për të cilët gjen zbatim kjo Konventë do të kenë po ato të drejta dhe detyrime ndaj legjislacionit të çdo Pale kontraktuese sikurse dhe shtetasit e kësaj Pale.
- 2 Megjithatë, përfitimi i të ardhurave me karakter jo kontributiv, shuma e të cilave është e pavarur nga kohëzgjatja e periudhave të banimit, mund të shihet në vartësi nga kushti që i interesuari të ketë banuar në territorin e Palës kontraktuese përkatëse apo, nëse është fjala për të ardhura për persona pasjetues, që personi i vdekur të ketë banuar në këtë territor për një kohëzgjatje që, sipas rastit, nuk mund të caktohet :
 - a mbi gjashtë muaj, duke i paraprirë menjëherë kërkesës për të ardhura, për sa i përket të ardhurave për barrë lindje dhe të ardhurave për papunësi ;
 - b mbi pesë vjet në vazhdimësi, duke i paraprirë menjëherë kërkesës për të ardhura, për sa i përket të ardhurave për invaliditet, apo duke i paraprirë menjëherë vdekjes, për sa i përket të ardhurave për personat pasjetues ;
 - c mbi dhjetë vjet midis moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe moshës për praninë pensioni pleqërie, nga të cilat pesë vjet në vazhdimësi mund të kërkojnë t'i paraprijnë menjëherë kërkesës për të ardhura, për sa i përket të ardhurave për pleqëri.
- 3 Nëse një person nuk i plotëson kushtet e parashikuara në nënparagrafin b apo në nënparagrafin c të paragrafit paraprirës, por nga ana tjetër ka qenë objekt – ose kur është fjala për të ardhura për personat pasjetues, nëse personi i vdekur ka qenë objekt – i legjislacionit të Palës kontraktuese përkatëse gjatë të paktën një viti, ky person apo pasjetuesit e personit të vdekur përfitojnë megjithatë, pa cënuar dispozitat e nenit 27, të ardhura të llogaritura mbi bazën dhe kufirin e shumës të së ardhurës së plotë :
 - a në rast invaliditeti apo vdekjeje, në përpjestim të numrit të viteve të banimit që ka plotësuar i interesuari apo personi i vdekur nën këtë legjislacion, midis datës kur ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe datës kur ka pësuar paaftësi në punë, pasuar nga invaliditeti apo vdekje, sipas rastit, me dy të tretat e numrit të viteve të plotësuar midis këtyre dy datave, pa mbajtur parasysh vitet pas moshës së fillimit të pensionit të pleqërisë ;
 - b në rast pleqërie, në përpjestim të numrit të viteve të banimit që ka plotësuar i interesuari nën këtë legjislacion, midis datës kur ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe datës kur ka arritur moshën e fillimit të pensionit të pleqërisë, me tridhjetë vjet.
- 4 Shtojca IV përmend, për çdo Palë kontraktuese të interesuar, të ardhurat që parashikon legjislacioni i saj, për të cilat gjejnë zbatim dispozitat e paragrafit 2 apo të paragrafit 3 të këtij neni.
- 5 Çdo Palë kontraktuese e interesuar do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë Shtojcës IV. Nëse ky amendament vjen nga miratimi i një legjislacioni të ri, notifikimi do të bëhet brenda tre muajve nga dita e shpalljes së këtij legjislacioni apo, nëse ky legjislacion është shpallur para datës së ratifikimit të kësaj Konvente, në ditën e këtij ratifikimi.

- 6 Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk çënojnë dispozitat ligjore të asnjë Pale kontraktuese, lidhur me pjesëmarrjen e të interesuarve në administrimin apo në juridiksionin e sigurimeve shoqërore.
- 7 Mund të parashikohen modalitete të veçanta për sa i përket pranimin në sigurimin vullnetar apo fakultativ të pandërprerë të personave që nuk banojnë në territorin e Palës kontraktuese përkatëse, apo për sa i përket përfitimit të të ardhurave të dhëna mbi bazën e sistemeve të ndërmjeme, për aq sa këto modalitete përmenden në Shtojcën VII.

Neni 9

- 1 Përfitimi nga dispozitat e konventave të sigurimeve shoqërore të mbajtura në fuqi në bazë të paragrafit 3 të nenit 6, si dhe nga dispozitat e sigurimeve shoqërore të arritura në bazë të paragrafit 1 të nenit 7, mund të shtrihet tek shtetasit e çdo Pale kontraktuese, në marrëveshje të përbashkët midis Palëve të lidhura nëpërmjet këtyre dispozitave.
- 2 Shtojca V përcakton dispozitat e konventave të sigurimeve shoqërore të mbajtura në fuqi në bazë të paragrafit 3 të nenit 6, përfitimi i të cilave shtrihet, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, tek shtetasit e çdo Pale kontraktuese.
- 3 Palët kontraktuese të interesuara do të notifikojnë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, dispozitat e konventave të sigurimeve shoqërore të arritura prej tyre në bazë të paragrafit 1 të nenit 7, përfitimi i të cilave shtrihet, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, tek shtetasit e çdo Pale kontraktuese. Dispozitat e këtyre konventave do të regjistrohen në Shtojcën V.
- 4 Dy a më shumë Palë kontraktuese të lidhura nga dispozitat që përmenden në Shtojcën V mund të bëjnë në këtë shtojcë, me marrëveshje të përbashkët, për aq sa u takon, amendamentet përkatëse, duke i notifikuar këto në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81.

Neni 10

Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e kushtëzohet pranimin në sigurimin vullnetar apo fakultativ të pandërprerë me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për të arritur totalin, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit të realizuara pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin me karakter jo kontributiv të çdo Pale tjetër kontraktuese, si të bëhej fjalë për periudha sigurimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.

Neni 11

- 1 Pa rënë në kundërshtim me këtë Konventë, të ardhurat në para për invaliditet, për pleqëri apo për persona pasjetues, rentat për aksidente në punë apo për sëmundje profesionale dhe pagesat për vdekje, që realizohen sipas legjislacionit të një a më shumë Palëve kontraktuese nuk mund të pësojnë asnjë pakësim, ndryshim, pezullim, heqje, konfiskim, thjesht për faktin që përfituesi banon në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ndodhet institucioni debitor.
- 2 Megjithatë, pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 8, të ardhurat për invaliditet, për pleqëri apo për personat pasjetues që përmenden në Shtojcën IV, llogariten në përputhje me dispozitat e nënparagrafit a apo të nënparagrafit b të paragrafit 3 të nenit 8, sipas rastit, kur përfituesi banon në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ndodhet institucioni debitor.
- 3 Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk gjejnë zbatim për të ardhurat e mëposhtme, për aq sa janë të regjistruara në Shtojcën VI :
 - a të ardhurat e veçanta me karakter jo kontributiv, që u jepen personave të paaftë për të fituar bukën e gojës për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore ;
 - b të ardhurat e veçanta me karakter jo kontributiv, që u jepen personave që nuk mund të përfitojnë të ardhura normale ;
 - c të ardhurat që jepen nga sisteme të ndërmjeme ;
 - d të ardhurat e veçanta që jepen si ndihmë apo duke marrë parasysh një gjendje të caktuar nevoje.
- 4 Çdo Palë kontraktuese e interesuar do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë Shtojcës VI. Nëse ky amendament bëhet pas miratimit të një legjislacioni të ri, notifikimi do të bëhet brenda tre muajve nga dita e shpalljes së këtij legjislacioni apo, nëse ky legjislacion shpallet para datës së ratifikimit të kësaj Konvente, në ditën e këtij ratifikimi.
- 5 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh rimbursimin e kontributeve të varur nga kushti që i interesuari të ketë pushuar së qenuri objekt i sigurimit të detyrueshëm, ky kusht nuk konsiderohet i plotësuar për aq kohë sa i interesuari mbetet objekt sigurimi i detyrueshëm në zbatim të legjislacionit të çdo Pale tjetër kontraktuese.
- 6 Palët kontraktuese do të përcaktojnë, me marrëveshje dypalëshe e shumëpalëshe, mënyrën për të kryer shërbimin e të ardhurave që parashikon paragrafi 1 i këtij neni për persona që janë pranuar të përfitojnë nga dispozitat e kësaj Konvente, kur këta persona banojnë në territorin e një shteti që nuk është Palë kontraktuese.

Neni 12

Rregullat lidhur me rivlerësimin e parashikuar nga legjislacioni i një Pale kontraktuese gjejnë zbatim në të ardhurat që jepen mbi bazën e këtij legjislacioni, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 13

- 1 Me përjashtim të të ardhurave për invaliditet, për pleqëri, për persona pasjetues apo për sëmundje profesionale që likuידohen nga institucionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese në përputhje me dispozitat e nenit 29 apo të nënparagrafit b të nenit 47, kjo Konventë nuk mund të japë as të ruajë të drejtën që një person të përfitojë nga shumë të ardhura të së njëjtës natyrë apo nga shumë të ardhura që kanë lidhje me të njëjtën periudhë sigurimi të detyrueshëm.
- 2 Klauzolat për pakësim, pezullim apo heqje përfitimesh që parashikon legjislacioni i një Pale kontraktuese, në rast bashkimi të një të ardhure me të ardhura të tjera apo me përfitime të tjera, apo për rrjedhojë të ushtrimit të një veprimtarie profesionale, i kundërvihen përfituesit, qoftë edhe kur është fjala për të ardhura të arritura mbi bazën e legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese apo kur është fjala për përfitime të realizuara si pasojë e një veprimtarie të ushtruar në territorin e një Pale tjetër kontraktuese. Megjithatë, për zbatimin e këtij rregulli, nuk mbahen parasysh të ardhurat e së njëjtës natyrë kur është fjala për invaliditet, për pleqëri, për persona pasjetues apo për sëmundje profesionale që paguhen nga institucionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese në përputhje me dispozitat e nenit 29 apo të nënparagrafit b të nenit 47.

Pjesa II – Dispozita lidhur me legjislacionin e zbatueshëm**Neni 14**

Për sa i përket personave të pranuar për të përfituar në kuadrin e dispozitave të kësaj Konvente, legjislacioni i zbatueshëm përcaktohet në përputhje me dispozitat e mëposhtme :

- a punonjësit me pagë të punësuar në territorin e një Pale kontraktuese janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale, qoftë edhe kur banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese apo kur ndërmarrja a punëdhënësi i tyre e ka qendrën apo vendqëndrimin në territorin e një Pale tjetër kontraktuese ;
- b punonjësit që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në një anije me flamurin e një Pale kontraktuese janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale ;
- c punonjësit e pavarur që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale në territorin e një Pale kontraktuese janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale, qoftë edhe kur banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese ;
- d funksionarët dhe personat e trajtuar si të tillë janë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese që ka në vartësi administratën ku ata punojnë.

Neni 15

- 1 Rregulli i shprehur në nënparagrafin a të nenit 14 përmban përjashtimet apo veçantitë e mëposhtme :
 - a i punonjësit me pagë të punësuar në territorin e një Pale kontraktuese nga një ndërmarrje prej së cilës varen zakonisht, që kalohen në territorin e një Pale tjetër kontraktuese nga po kjo ndërmarrje për të kryer aty një punë për llogari të saj, mbeten objekt i legjislacionit të Palës së parë, me kusht që koha e parashikuar për këtë punë të mos i kalojë dymbëdhjetë muaj dhe që të mos dërgohen për të zëvendësuar punonjës të tjerë të cilëve u ka përfunduar periudha e shkëputjes ;

-
- ii nëse koha për punën që do kryhet, për shkak të rrethanave të paparashikuara zgjatet mbi kohën e parashikuar paraprakisht, duke i tejkaluar dymbëdhjetë muajt, legjislacioni i Palës së parë mbetet i zbatueshëm deri në përfundimin e kësaj pune, me kusht që të japë miratimin e vet autoriteti kompetent i Palës së dytë apo organizmi i përcaktuar prej tij ;
 - b
 - i punonjësit me pagë të transporteve ndërkombëtare të punësuar në territorin e dy a më shumë Palëve kontraktuese si personnet transporti në shërbim të një ndërmarrjeje, e cila e ka qendrën e vet në territorin e një Pale kontraktuese dhe që kryen për llogari të dikujt apo për llogari të saj transportim pasagjerësh a mallrash, me hekurudhë, rrugë tokësore, ajrore apo lundruese të brendshme, janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale;
 - ii megjithatë, nëse ata janë të punësuar nga një degë apo agjenci e përhershme që ndërmarrja në fjalë zotëron në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ajo ka qendrën e vet, ata do të jenë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ndodhet kjo degë apo agjenci e përhershme ;
 - iii nëse ata janë të punësuar kryesisht në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, ata janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale, qoftë edhe kur ndërmarrja që i ka punësuar nuk ka as qendër, as degë, as agjenci të përhershme në këtë territor ;
 - c
 - i punonjësit me pagë të ndryshëm nga ata të transporteve ndërkombëtare, që ushtrojnë normalisht veprimtarinë e tyre në territorin e dy a më shumë Palëve kontraktuese, janë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ata banojnë, nëse ushtrojnë një pjesë të veprimtarisë së tyre në këtë territor apo nëse varen nga shumë ndërmarrje apo nga shumë punëdhënës me qendër apo vendndodhje në territorin e Palëve të ndryshme kontraktuese ;
 - ii në rastet e tjera, ata janë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ka qendrën a vendndodhjen e saj ndërmarrja apo punëdhënësi që i ka punësuar ;
 - d punonjësit me pagë të punësuar në territorin e një Pale kontraktuese nga një ndërmarrje e cila e ka qendrën e vet në territorin e një Pale tjetër kontraktuese dhe që përshkon kufirin e përbashkët të këtyre Palëve janë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës kjo ndërmarrje ka qendrën e vet.
- 2 Rregulli i parashtruar në nënparagrafin b të nenit 14 përmban përjashtimet e mëposhtme :
- a punonjësit me pagë, të punësuar nga një ndërmarrje prej së cilës varen normalisht, qoftë në territorin e një Pale kontraktuese, qoftë në një anije me flamurin e një Pale kontraktuese, që shpëputen nga kjo ndërmarrje me qëllim që të kryejnë punë për llogari të saj në një anije me flamurin e një Pale tjetër kontraktuese mbeten objekt i legjislacionit të Palës së parë, në vartësi të kushteve të parashikuara në nënparagrafin a të paragrafit 1 të këtij neni ;
 - b punonjësit që ushtrojnë normalisht veprimtarinë e tyre në ujrat territoriale apo në një port të një Pale kontraktuese, mbi një anije me flamurin e një Pale tjetër kontraktuese, pa qenë pjesë e ekuipazhit të kësaj anijeje, janë objekt i legjislacionit të Palës së parë ;

Unofficial, unrevised translation

- c punonjësit me pagë të punësuar në një anije me flamurin e një Pale kontraktuese, që paguhet për këtë punësim nga një ndërmarrje apo një person që e ka qendrën apo selinë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, janë objekt i legjislacionit të kësaj Pale të fundit, nëse vendbanimin e tyre e kanë në territorin e saj ; ndërmarrja apo personi që jep pagën konsiderohet si punëdhënës për zbatimin e legjislacionit në fjalë.
- 3 Rregulli i parashtruar në nënparagrafin c të nenit 14 përmban përjashtimet apo veçantitë e mëposhtme :
- a punonjësit e pavarur që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese dhe që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e një Pale tjetër kontraktuese janë objekt i legjislacionit të Palës së parë :
- i nëse Pala e dytë nuk ka legjislacion që të jetë i zbatueshëm për ta, apo
- ii nëse, sipas legjislacionit të të dyja Palëve në fjalë, punonjësit e pavarur janë objekt i një legjislacioni të tillë për të vetmen arsye të banimit të tyre në territorin e këtyre Palëve ;
- b punonjësit e pavarur që ushtrojnë normalisht veprimtarinë e tyre në territorin e dy a më shumë Palëve kontraktuese janë objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ata banojnë, nëse ushtrojnë një pjesë të veprimtarisë së tyre në këtë territor apo nëse, sipas këtij legjislacioni, ata janë objekt për të vetmen arsye të banimit të tyre në territorin e kësaj Pale ;
- c në rastin kur punonjësit e pavarur që përmenden në nënparagrafin e mësipërm nuk ushtrojnë një pjesë të veprimtarisë së tyre në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, apo nëse, sipas legjislacionit të kësaj Pale, nuk janë objekt për të vetmen arsye të banimit të tyre, apo nëse kjo Palë nuk ka legjislacion që të jetë i zbatueshëm për ta, ata janë objekt i legjislacionit të përcaktuar me marrëveshje të përbashkët midis Palëve kontraktuese të interesuara apo midis autoriteteve të tyre kompetente.
- 4 Nëse, në bazë të paragrafëve paraprirës të këtij neni, një punonjës i nënshtrohet legjislacionit të një Pale kontraktuese në territorin e së cilës ai nuk ushtron veprimtari profesionale, ky legjislacion është i zbatueshëm për të, si të ushtronte një veprimtari të tillë në territorin e kësaj Pale.

Neni 16

- 1 Dispozitat e neneve 14 dhe 15 nuk janë të zbatueshme në fushën e sigurimit vullnetar apo fakultativ të pandërprerë.
- 2 Në rastin kur zbatimi i legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese do të sillte si rezultat përfshirjen në një sistem sigurimi të detyrueshëm dhe do të mundësonte nga ana tjetër pranimin e njëkohshëm në një apo disa sisteme sigurimi vullnetar a fakultativ të pandërprerë, i interesuari është objekt vetëm i sistemit të sigurimit të detyrueshëm. Megjithatë, kur është fjala për invaliditet, pleqëri dhe vdekje (për pensione), kjo Konventë nuk çënon dispozitat ligjore të asnjë Pale kontraktuese që lejojnë futjen e njëkohshme në sigurimin vullnetar apo fakultativ të pandërprerë dhe në sigurimin e detyrueshëm.
- 3 Në rastin kur zbatimi i legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese do të bënte të mundur pranimin në dy a më shumë sisteme sigurimi vullnetar apo fakultativ të pandërprerë, personi përkatës nuk mund të pranohet përveçse në sistemin e sigurimit vullnetar apo fakultativ të pandërprerë të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon apo, nëse nuk banon në territorin e njërës prej këtyre Palëve, të asaj Pale për legjislacionin e së cilës ai ka bërë përzgjedhjen e tij.

Neni 17

- 1 Dispozitat e nënparagrafit a të nenit 14 janë të zbatueshme për anëtarët e personelit të misioneve diplomatike apo posteve konsullore dhe për personat në shërbim privat të zyrtarëve të këtyre misioneve apo posteve.
- 2 Megjithatë, punonjësit me pagë përmendur në paragrafin e mësipërm që janë shtetas të një Pale kontraktuese, e cila është shteti akreditues apo dërgues, mund të zgjedhin për zbatim legjislacionin e kësaj Pale. Kjo e drejtë përzgjedhjeje ushtrohet vetëm një herë, brenda tre muajve që pasojnë hyrjen në fuqi të kësaj Konvente apo nga dita kur i interesuari bën pjesë në misionin diplomatik a në postin konsullor apo është vënë në shërbim privat të zyrtarëve të këtij misioni a të këtij posti, sipas rastit. Përzgjedhja hyn në fuqi ditën kur fillon zbatimi i saj.

Neni 18

- 1 Autoritetet kompetente të dy a më shumë Palëve kontraktuese mund të parashikojnë, me marrëveshje të përbashkët, përjashtime nga dispozitat e neneve 14 deri në 17 në favor të të interesuarve.
- 2 Në rast nevoje, zbatimi i dispozitave të paragrafit të mësipërm do të bëhet me kërkesë të punonjësve të interesuar dhe, kur lypset, me kërkesë të punëdhënësve të tyre. Veç kësaj, një zbatim i tillë do të jetë objekt i një vendimi me anë të të cilit autoriteti kompetent i Palës kontraktuese, legjislacioni i së cilës duhej zbatuar, do të vërtetohet se punonjësit në fjalë nuk do të jenë më objekt i këtij legjislacioni, për të qenë kështu efektivisht objekt i legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese.

Pjesa III – Dispozita të veçanta për kategori të ndryshme të ardhurash**Kreu 1 – Sëmundje e barrë lindje****Neni 19**

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e kushtëzon arritjen, mbajtjen dhe realizimin e së drejtës për të ardhura me plotësimin e periudhave të sigurimit, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysht për këtë qëllim, për aq sa është e nevojshme për të arritur totalin, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevoje, periudhat e banimit pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç, me karakter jo kontributiv, të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si të bëhej fjalë për periudha sigurimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e kushtëzon pranimin në sigurimin e detyrueshëm me plotësimin e periudhave të sigurimit, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevoje, periudhat e banimit pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç, me karakter jo kontributiv, të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese mbahen parasysht për këtë qëllim, për aq sa është e nevojshme për të arritur totalin, si të bëhej fjalë për periudha sigurimi të plotësuara nën legjislacionin e Palës së parë.

Neni 20

- 1 Personat që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent dhe që plotësojnë kushtet e njohura nga legjislacioni i këtij shteti për të patur të drejta për të ardhura, duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 19, gëzojnë, në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë, të drejtën për :
 - a të ardhura në natyrë, që jepen në ngarkim të institucionit kompetent nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky institucion i fundit, sikur personat përkatës të qenë objekt i tij ;
 - b të ardhura në para që jepen nga institucioni kompetent, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton, sikur këta persona të kishin vendbanimin në territorin e shtetit kompetent. Megjithatë, duke hyrë në marrëveshje institucioni kompetent me institucionin e vendbanimit, të ardhurat në para mund të jepen gjithashtu me ndërmjetësinë e këtij institucioni të fundit për llogari të institucionit kompetent.
- 2 Dispozitat e paragrafit paraprirës janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për pjesëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent për sa i përket përfitimit të të ardhurave në natyrë.
- 3 Të ardhurat mund t'u jepen gjithashtu punonjësve kufitarë nga institucioni kompetent në territorin e shtetit kompetent, sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, sikur këta të qenë banues në territorin e tij. Megjithatë, pjesëtarët e familjeve të tyre pranohen për të përfituar të ardhura në natyrë, në të njëjtat kushte, vetëm kur është arritur marrëveshje midis autoriteteve kompetente të Palëve kontraktuese të interesuara apo, në mungesë të saj, kur është lëshuar autorizim paraprak nga institucioni kompetent, me përjashtim të rasteve urgjente.
- 4 Nëse personat e përmendur në këtë nen, të ndryshëm nga punonjësit kufitarë apo nga pjesëtarët e familjeve të tyre, janë me qëndrim të përkohshëm në territorin e shtetit kompetent, ata gëzojnë të drejtën për të ardhura sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, sikur të qenë banues në territorin e tij, edhe pse kanë përfituar tashmë të ardhura për të njëjtin rast sëmundjeje apo barrë lindjeje para fillimit të qëndrimit të tyre.
- 5 Nëse personat e përmendur në këtë nen e transferojnë banimin e tyre në territorin e shtetit kompetent, ata gëzojnë të drejtën për të ardhura sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, edhe pse kanë përfituar të ardhura për të njëjtin rast sëmundjeje apo barrë lindjeje para transferimit të banimit të tyre.

Neni 21

- 1 Personat që plotësojnë kushtet e kërkuara nga legjislacioni i shtetit kompetent lidhur me të drejtën për të ardhura duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 19, dhe
 - a kur gjendja e tyre kërkon menjëherë të ardhura gjatë një qëndrimi të përkohshëm në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, apo
 - b kur, pasi janë pranuar për të përfituar të ardhura në ngarkim të institucionit kompetent, autorizohen nga ky institucion të rikthehen në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent ku ata banojnë, apo të transferojnë banimin e tyre në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, apo

Unofficial, unrevised translation

- c kur autorizohen nga institucioni kompetent të shkojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, për të marrë mjekime të nevojshme për shëndetin e tyre,
- përfitojnë :
- i të ardhura në natyrë që jepen në ngarkim të institucionit kompetent, nga institucioni i vendqëndrimit të përkohshëm apo i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky institucion, sikur këta persona të qenë objekt i këtyre dispozitave, brenda një kufiri kohor të përcaktuar, në rast nevojë, nga legjislacioni i shtetit kompetent ;
 - ii të ardhura në para që jepen nga institucioni kompetent sipas dispozitave ligjore që ai zbaton, sikur këta persona të ndodheshin në territorin e shtetit kompetent. Megjithatë, në marrëveshje midis institucionit kompetent dhe institucionit të vendqëndrimit apo të vendbanimit, të ardhurat në para mund të jepen gjithashtu nëpërmjet institucionit të fundit për llogari të institucionit kompetent.
- 2 a Autorizimi i përmendur në nënparagrafin b të paragrafit të mësipërm mund të kundërshtohet vetëm po qe se zhvendosja e të interesuarit është e një natyre të tillë që vë në rrezik gjendjen e tij shëndetësore apo zbatimin e një trajtimi mjekësor ;
- b autorizimi i përmendur në nënparagrafin c të paragrafit të mësipërm nuk mund të kundërshtohet kur mjekimet për të cilat bëhet fjalë nuk mund t'i bëhen të interesuarit në territorin e Palës kontraktuese ku ai banon.
- 3 Dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë të zbatueshme *mutatis mutandis* për pjesëtarët e familjes, kur është fjala për përfitim të ardhurash në natyrë.

Neni 22

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh dhënien e të ardhurave në natyrë për pjesëtarët e familjes të varur nga kushti që këta vetë të jenë personalisht të siguruar, dispozitat e neneve 20 dhe 21 janë të zbatueshme për pjesëtarët e familjes të një personi që është objekt i këtij legjislacioni vetëm po qe se ata janë përfshirë personalisht ose në të njëjtin institucion të Palës në fjalë të këtij personi, ose në një institucion tjetër të Palës në fjalë që jep të ardhurat përkatëse.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që përlllogaritja e të ardhurave në para mbështetet mbi një fitim mesatar, institucioni kompetent i kësaj Pale përcakton këtë fitim mesatar vetëm mbi bazën e fitimeve të arritura gjatë periudhave kur është zbatuar ky legjislacion.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që përlllogaritja e të ardhurave në para mbështetet mbi një fitim të paracaktuar, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysht vetëm këtë fitim të paracaktuar apo, në rast nevojë, mesataren e fitimeve të paracaktuara gjatë periudhave kur është zbatuar ky legjislacion.
- 4 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që shuma e të ardhurave në para ndryshon në raport me numrin e anëtarëve të familjes, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysht gjithashtu anëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, sikur këta të banonin në territorin e Palës së parë.

Neni 23

Të papunët që plotësojnë kushtet e kërkuara nga legjislacioni i Palës kontraktuese e cila përgjigjet me të ardhurat për papunësi nëpërmjet së drejtës për të ardhura në natyrë, mbi bazën, në rast nevojë, të dispozitave të nenit 19, përfitojnë të ardhura në natyrë, po ashtu edhe anëtarët e familjeve të tyre, kur këta banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese. Në këtë rast, të ardhurat në natyrë jepen nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave të legjislacionit që zbaton ky institucion, sikur personi i interesuar të kishte të drejtën për të ardhura të tilla në bazë të këtij legjislacioni, por kostoja në këtë rast i ngarkohet institucionit kompetent të Palës së parë.

Neni 24

- 1 Kur titullari për pensione a renta të njohura nga legjislacionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese ka të drejtë për të ardhura në natyrë sipas legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon, duke mbajtur parasysh, në rast nevojë, dispozitat e nenit 19, këto të ardhura i jepen këtij titullari, si dhe anëtarëve të familjes së tij, nga institucioni i vendbanimit dhe në ngarkim të këtij institucioni, sikur ai të qe titullar i një pensioni a rente të njohur vetëm nga legjislacioni i Palës së fundit.
- 2 Kur titullari për një pension a rentë të njohur nga legjislacioni i një Pale kontraktuese, apo për pensione a renta të njohura nga legjislacionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese, nuk ka të drejtë për të ardhura në natyrë sipas legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon, ai megjithatë gëzon të drejtën për të përfitur nga këto të ardhura, po ashtu edhe anëtarët e familjes së tij, mjaft që të ketë të drejtën për të ardhura të tilla në bazë të legjislacionit të Palës së parë apo të njëres prej Palëve të para, duke mbajtur parasysh, në rast nevojë, dispozitat e nenit 19, apo mjaft që të kishte të drejtë nëse do banonte në territorin e njëres prej këtyre Palëve. Të ardhurat në natyrë jepen nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave të legjislacionit që zbaton ky institucion, sikur personi përkatës të gëzonte të drejtën për të ardhura të tilla në bazë të këtij legjislacioni, por kostoja në këtë rast i ngarkohet institucionit të përcaktuar sipas rregullave që parashtrihen në paragrafin e mëposhtëm.
- 3 Në rastet e përmendura në paragrafin e mësipërm, kostoja për të ardhurat në natyrë i takon institucionit të përcaktuar sipas rregullave të mëposhtme :
 - a nëse titullari ka të drejtë për të ardhura të tilla në bazë të legjislacionit të një Pale të vetme kontraktuese, kostoja për këtë i takon institucionit kompetent të kësaj Pale ;
 - b nëse titullari ka të drejtë për të ardhura të tilla në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, kostoja për këtë i takon institucionit kompetent të Palës kontraktuese nën legjislacionin e së cilës titullari ka plotësuar periudhën më të gjatë të sigurimit apo vendbanimit ; në rastin kur, në zbatim të këtij rregulli, kostoja e të ardhurave do duhej t'i ngarkohej shumë institucioneve, kostoja i takon institucionit të Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës titullari ka qenë objekt për herë të fundit.
- 4 Kur anëtarët e familjes së titullarit të një pensioni a rente të njohur në bazë të legjislacionit të një Pale kontraktuese, apo të pensioneve a rentave të njohura në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga ajo ku banon ky titullar, ata përfitojnë të ardhura në natyrë sikur titullari të banonte në të njëjtin territor me ta, për aq sa ai ka të drejtë për të ardhura të tilla në bazë të legjislacionit të një Pale kontraktuese. Këto të ardhura jepen nga institucioni i vendbanimit të anëtarëve të familjes, sipas dispozitave të legjislacionit që ai zbaton, sikur ata të kishin të drejtë për të ardhura të tilla në bazë të këtij legjislacioni, por kostoja në këtë rast i ngarkohet institucionit të vendbanimit të titullarit.
- 5 Nëse anëtarët e familjes të përmendur në paragrafin paraprirës e transferojnë banimin në territorin e Palës kontraktuese ku banon titullari, ata përfitojnë të ardhura, sipas dispozitave të legjislacionit të kësaj Pale, edhe pse kanë përfitur tashmë të ardhura për të njëjtin rast sëmundjeje apo barrëindjeje para transferimit të banimit të tyre.
- 6 Titullari i një pensioni a rente të njohur nga legjislacioni i një Pale kontraktuese, apo i pensioneve a rentave të njohura nga legjislacionet e dy a më shumë Palëve kontraktuese, i cili ka të drejtë për të

Unofficial, unrevised translation

ardhura në natyrë sipas legjislacionit të njëres prej këtyre Palëve, përfiton të ardhura të tilla, po ashtu edhe anëtarët e familjes së tij :

- a gjatë një qëndrimi të përkohshëm në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga ajo ku ata banojnë, dhe kur gjendja e tyre është e tillë që kërkon menjëherë të ardhura ; apo
 - b kur ata janë autorizuar nga institucioni i vendbanimit të shkojnë në territorin e një Pale kontraktuese i ndryshëm nga territori ku ata banojnë, për të përfituar perkujdesjet e nevojshme për gjendjen e tyre.
- 7 Në rastet e përmendura në paragrafin e mësipërm, të ardhurat në natyrë jepen nga institucioni i vendqëndrimit, sipas dispozitave të legjislacionit që ai zbaton, sikur i interesuari të kishte të drejtë për të ardhura të tilla në bazë të këtij legjislacioni, por kostoja në këtë rast i ngarkohet institucionit të vendbanimit të titullarit.
- 8 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon mbajtje kuote nga pensioni apo renta e titullarit për të garantuar të ardhurat në natyrë, institucioni i kësaj Pale, që paguan pensionin apo rentën, është i autorizuar të realizojë këtë mbajtje kur kostoja e të ardhurave në natyrë i është ngarkuar institucionit të Palës në fjalë në bazë të këtij neni.

Neni 25

- 1 Nëse legjislacioni që zbaton institucioni i vendbanimit apo i vendqëndrimit përmban shumë sisteme sigurimi për sëmundje a barrë lindje, dispozitat e zbatueshme në shërbim të të ardhurave në natyrë, në rastet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të nenit 20, në paragrafët 1 dhe 3 të nenit 21, në nenin 23 dhe në paragrafët 2, 4 dhe 6 të nenit 24, do të jenë ato të sistemit të përgjithshëm apo, në mungesë, të sistemit prej të cilit varen punonjësit e industrisë.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e kushtëzon dhënien e të ardhurave me origjinën e sëmundjes, ky kusht nuk i kundërvihet personave për të cilët kjo Konventë gjen zbatim, cilido qoftë territori i Palës kontraktuese ku ata banojnë.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese përcakton një kohë maksimale për dhënie të ardhurash, institucioni që zbaton këtë legjislacion mund të mbajë parasysh, në rast nevoje, priudhën gjatë së cilës janë dhënë tashmë të ardhura nga institucioni i një Pale tjetër kontraktuese për të njëjtin rast sëmundjeje apo barrë lindjeje.

Neni 26

- 1 Zbatimi i dispozitave të neneve 20, 21, 23 dhe 24 midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe midis vetë këtyre Palëve, të cilat mund të parashikojnë nga ana tjetër modalitetet e veçanta përkatëse.

-
- 2 Marrëveshjet e përmendura në paragrafin e mësipërm do të përcaktojnë konkretisht :
- a kategoritë e personave ndaj të cilëve zbatohen dispozitat e neneve 20, 21, 23 dhe 24 ;
 - b kohën gjatë së cilës mund të realizohet dhënia e të ardhurave në natyrë nga institucioni i një Pale kontraktuese për llogari të institucionit të një Pale tjetër kontraktuese ;
 - c kushtet e veçanta lidhur me dhënie protezash, mjetesh shëndetësore ndihmëse dhe të ardhura të tjera në natyrë me përfitim të madh ;
 - d rregullat për të shmangur mbledhje të ardhurash të së njëjtës natyrë ;
 - e modalitetet e rimbursimit të të ardhurave që jep institucioni i një Pale kontraktuese për llogari të institucionit të një Pale tjetër kontraktuese.
- 3 Dy a më shumë Pale kontraktuese mund të merren vesh për të hequr dorë nga çdo rimbursim mes institucioneve që varen nga kompetencat e tyre.

Kreu 2 – Invaliditet, pleqëri dhe vdekje (pensione)

Nënndarja 1 – Dispozita të përbashkëta

Neni 27

Kur një person ka qenë vazhdimisht apo me ndërprerje objekt i legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, ky person apo pasjetuesit e tij përfitojnë të ardhura në përputhje me dispozitat e këtij kreu, edhe në rastin kur të interesuarit do të kërkonin t'u njiheshin të drejtat për të ardhura sipas legjislacionit të një a shumë Palëve kontraktuese pa zbatim të këtyre dispozitave.

Neni 28

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për të ardhura në vartësi të kryerjes së periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysht për këtë qëllim, për të arritur totalin, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin me karakter jo kontributiv të çdo Pale tjetër kontraktuese, si të bëhej fjalë për periudha sigurimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për të ardhura në vartësi të kryerjes së periudhave të banimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysht për këtë qëllim, për të arritur totalin, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin me karakter jo kontributiv të çdo Pale tjetër kontraktuese, si të bëhej fjalë për periudha banimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.
- 3 Nëse, në bazë të legjislacionit të një Pale kontraktuese, një person ka qenë njëkohësisht objekt i një sistemi me karakter kontributiv dhe i një sistemi me karakter jo kontributiv për të njëjtin rast, institucioni i çdo Pale tjetër kontraktuese në fjalë mban parasysht, për zbatimin e paragrafëve 1 apo 2 të këtij neni, periudhën më të gjatë të sigurimit apo banimit të kryer nën legjislacionin e Palës së parë.
- 4 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh dhënien e disa të ardhurave të varur nga kushti që periudhat e sigurimit të jenë kryer në një profesion të trajtuar si objekt i një sistemi të veçantë apo, në fund të fundit, në një profesion apo post të përcaktuar, periudhat e kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese merren parasysht për dhënien e këtyre të ardhurave vetëm nëse ato janë kryer në një sistem korrespondues apo, në mungesë, në të njëjtin profesion apo, më tej, në të njëjtin post. Nëse, nisur nga periudhat e kryera në këtë mënyrë, i interesuari nuk i plotëson kushtet e duhura për të përfituar të ardhurat në fjalë, këto periudha merren parasysht për dhënie të ardhurash në bazë të sistemit të përgjithshëm apo, në mungesë, të sistemit që zbatohet për punëtorët a për nëpunësit, sipas rastit.

- 5 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese, që nuk kërkon asnjë periudhë sigurimi apo punësimi për njohjen dhe përcaktimin e së drejtës për të ardhura, e sheh dhënien e tyre të varur nga kushti që i interesuari apo, kur bëhet fjalë për të ardhura për pasjetuesit, personi i vdekur të kenë qenë objekt i këtij legjislacioni në çastin e realizimit të kësaj mundësie, ky kusht quhet i plotësuar nëse personi përkatës apo personi i vdekur, sipas rastit, kanë qenë në atë kohë objekt i legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese.
- 6 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që periudha gjatë së cilës është dhënë një pension a një rentë mund të merret parasysh për arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për të ardhura, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysh, për këtë qëllim, periudhën gjatë së cilës është dhënë një pension a një rentë në bazë të legjislacionit të çdo Pale tjetër kontraktuese.

Neni 29

- 1 Institucioni i çdo Pale kontraktuese, në legjislacionin e së cilës i interesuari ka qenë objekt i saj, vendos, sipas dispozitave ligjore që zbaton, nëse ky person i plotëson kushtet e nevojshme për të fituar të ardhura, duke mbajtur parasysh, në rast nevojë, dispozitat e nenit 28.
- 2 Në rastin kur i interesuari i plotëson këto kushte, institucioni në fjalë llogarit shumën teorike të së ardhurës për të cilën mund të pretendojë personi përkatës, sikur të gjitha periudhat e sigurimit e të banimit, të kryera nën legjislacionet e Palëve kontraktuese në fjalë dhe të marra parasysh në përputhje me dispozitat e nenit 28, për përcaktimin e së drejtës, të kenë qenë plotësuar vetëm nën legjislacionin që zbaton ky institucion.
- 3 Megjithatë,
 - a nëse bëhet fjalë për të ardhura, shuma e të cilave është e pavarur nga kohëzgjatja e periudhave të kryera, kjo shumë konsiderohet si shuma teorike e përmendur në paragrafin e mësipërm ;
 - b nëse bëhet fjalë për të ardhura që përmenden në Shtojcën IV, shuma teorike e parashikuar në paragrafin e mësipërm mund të llogaritet mbi bazën e të ardhurës së plotë, pa e tejkaluar këtë të ardhur :
 - i në rast invaliditeti apo vdekjeje, në përpjestim të kohës së përgjithshme të periudhave të sigurimit e të banimit që ka kryer i interesuari apo personi i vdekur para realizimit të mundësisë nën legjislacionet e të gjitha Palëve kontraktuese në fjalë dhe të marra parasysh në përputhje me dispozitat e nenit 28, me dy të tretat e numrit të viteve të realizuara midis datës në të cilën i interesuari apo personi i vdekur ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe datës në të cilën ka ndodhur paaftësia për punë pasuar nga invaliditet apo vdekje, sipas rastit, pa mbajtur parasysh vitet pas moshës së pranimit për pension pleqërie ;
 - ii në rast pleqërie, në përpjestim të kohës së përgjithshme të periudhave të sigurimit e të banimit të kryera nga i interesuari nën legjislacionet e të gjitha Palëve kontraktuese në fjalë dhe të marra parasysh në përputhje me dispozitat e nenit 28, me tridhjetë vjet, pa mbajtur parasysh vitet pas moshës së pranimit për pension pleqërie.
- 4 Institucioni në fjalë përcakton më pas shumën efektive të së ardhurës që ai i detyrohet personit përkatës, mbi bazën e shumës teorike për llogaritjen në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 apo të paragrafit 3 të këtij neni, sipas rastit, në përpjestim të kohës së periudhave të sigurimit apo banimit të kryera para realizimit të mundësisë nën legjislacionin që ai zbaton, me kohën e përgjithshme të periudhave të sigurimit e banimit të kryera para realizimit të mundësisë nën legjislacionet e të gjitha Palëve kontraktuese përkatëse.
- 5 Në rastet kur legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që shuma e të ardhurave apo e disa komponentëve të të ardhurave është në përpjestim me kohën e periudhave të sigurimit apo të banimit të kryera, institucioni kompetent i kësaj Pale mund të bëjë llogaritjen e drejtpërdrejtë të këtyre të ardhurave apo komponentëve të të ardhurave, në funksion vetëm të periudhave të realizuara nën legjislacionin që ai zbaton, pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2 deri në 4 të këtij neni.

Neni 30

- 1 Për të llogaritur shumën teorike të përmendur në paragrafin 2 të nenit 29 :
 - a nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave mbështetet mbi një fitim mesatar, një kontribut mesatar, një shtesë mesatare apo mbi një marrëdhënie ekzistuese gjatë periudhës së sigurimit midis fitimit bruto të të interesuarit dhe mesatares së fitimeve bruto të të gjithë të siguruarve me përjashtim të nxënësve në zanat, këto shifra mesatare apo proporcionale përcaktohen nga institucioni kompetent i kësaj Pale vetëm në bazë të periudhave të kryera nën legjislacionin e kësaj Pale apo të fitimit bruto të marrë nga i interesuari vetëm gjatë këtyre periudhave ;
 - b nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave mbështetet mbi shumën e fitimeve, kontributeve apo shtesave të mundshme, fitimet, kontributet apo shtesat që do mbahen parasysh nga institucioni kompetent i kësaj Pale, sipas periudhave të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, përcaktohen në bazë të mesatares së fitimeve, kontributeve apo shtesave të konstatuara për periudhat e kryera nën legjislacionin e Palës së parë ;
 - c nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave mbështetet mbi një fitim apo mbi një shumë të paracaktuar, fitimi apo shuma që do merret parasysh nga institucioni kompetent i kësaj Pale, në bazë të periudhave të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, është e barabartë me fitimin apo shumën e paracaktuar apo, në rast nevojë, me mesataren e fitimeve apo shumave të paracaktuara që i përgjigjen periudhave të kryera nën legjislacionin e Palës së parë ;
 - d nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave mbështetet, për disa periudha, mbi shumën e fitimeve, dhe për disa periudha të tjera, mbi një fitim apo mbi një shumë të paracaktuar, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysh, në bazë të periudhave të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, fitimet apo shumat e përcaktuara në përputhje me dispozitat e nënparagrafit b apo të nënparagrafit c të këtij paragrafi, sipas rastit ; nëse për të gjitha periudhat e kryera nën legjislacionin e Palës së parë, llogaritja e të ardhurave mbështetet mbi një fitim apo mbi një shumë të paracaktuar, fitimi që mbahet parasysh nga institucioni kompetent i kësaj Pale, në bazë të periudhave të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese, është e barabartë me fitimin joreal që i përgjigjet këtij fitimi apo shume të paracaktuar.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese përmban rregulla rivlerësimi të komponentëve që duhen mbajtur parasysh për llogaritjen e të ardhurave, këto rregulla janë të zbatueshme, në rast nevojë, për komponentët që shqyrtohen nga institucioni kompetent i kësaj Pale, në përputhje me dispozitat e paragrafit paraprirës, në bazë të periudhave të kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që shuma e të ardhurave ndryshon në funksion të numrit të anëtarëve të familjes, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysh gjithashtu anëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, sikur këta të banonin në territorin e Palës së parë.

Neni 31

- 1 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 29, nëse koha e përgjithshme e periudhave të sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin e një Pale kontraktuese nuk e plotëson një vit dhe nëse, duke mbajtur parasysh thjesht këto periudha, asnjë e drejtë për të ardhura nuk arrihet në bazë të këtij legjislacioni, institucioni kompetent i kësaj Pale nuk është i detyruar të japë të ardhura për këto periudha.

Unofficial, unrevised translation

- 2 Periudhat e përmendura në paragrafin e mësipërm merren parasysh nga institucioni i çdonjëres prej Palëve të tjera kontraktuese në fjalë për të zbatuar dispozitat e nenit 29, me përjashtim të paragrafit 4 të tij.
- 3 Megjithatë, në rast se zbatimi i dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni do t'i shkarkonte të gjitha institucionet në fjalë nga detyrimi për dhënie të ardhurash, të ardhurat do të jepen tërësisht mbi bazën e legjislacionit të Palës së fundit kontraktuese, kushtet e së cilës plotëson i interesuari, duke mbajtur parasysh dispozitat e nenit 28, sikur të gjitha periudhat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni të qenë kryer nën legjislacionin e kësaj Pale.

Neni 32

- 1 Pavarësisht nga dispozitat e nenit 29, nëse koha e përgjithshme e periudhave të sigurimit apo të banimit të kryera nën legjislacionin e një Pale kontraktuese është të paktën e barabartë me një vit, por nën pesë vjet, institucioni i kësaj Pale nuk është i detyruar të japë të ardhura për pleqëri për periudhat në fjalë.
- 2 Periudhat që përmenden në paragrafin e mësipërm merren parasysh për zbatimin e nenit 29, nga institucioni i Palës kontraktuese nën legjislacionin e së cilës personi përkatës ka kryer periudhën më të gjatë të sigurimit apo të banimit, sikur këto periudha të qenë kryer nën legjislacionin e kësaj Pale. Në rastin kur, sipas këtij rregulli, periudhat në fjalë do duhej të merreshin parasysh nga shumë institucione, atëherë ato do mbahen parasysh nga institucioni i Palës kontraktuese në legjislacionin e së cilës personi përkatës ka qenë së fundi objekt i tij.
- 3 Institucioni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni bën tek institucioni i përmendur në paragrafin 2, për efekt bilanci pagese, transfertë të një shume të paracaktuar, të barabartë me dhjetëfishin e shumës vjetore të asaj pjese të ardhurash që duhet të shërbejë ky institucion, në përputhje me dispozitat e nenit 29, mbi bazën e periudhave të kryera nën legjislacionin që zbaton institucioni i parë. Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese përkatëse mund të bien në ujdi për modalitete të ndryshme kompensimi të detyrimeve lidhur me këto periudha.
- 4 Megjithatë, në rast se zbatimi i dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni do t'i shkarkonte të gjitha institucionet në fjalë nga detyrimi për dhënie të ardhurash, të ardhurat jepen në përputhje me dispozitat e nenit 29.
- 5 Në rastin kur zbatimi i përbashkët i dispozitave të paragrafit 1 të nenit 31 dhe të paragrafit 1 të këtij neni do t'i shkarkonte të gjitha institucionet në fjalë nga detyrimi për dhënie të ardhurash, të ardhurat jepen në përputhje me dispozitat e nenit 29, pa cënuar dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 31.
- 6 Zbatimi i dispozitave të paragrafëve të mësipërm të këtij neni nga ana e dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga përfundimi i marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe që lidhin këto Palë dhe kufizohet vetëm në rastet kur personat përkatës kanë qenë tërësisht objekt i legjislacioneve të këtyre Palëve.

Neni 33

- 1 Nëse i interesuari, në një çast të dhënë, nuk plotëson kushtet që kërkojnë legjislacionet e të gjitha Palëve kontraktuese në fjalë, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 28, por plotëson vetëm kushtet e njëres apo të disa prej tyre, dispozitat e mëposhtme janë të zbatueshme :
 - a shuma e të ardhurave për t'u paguar llogaritet në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2 deri në 4 apo të paragrafit 5 të nenit 29, sipas rastit, nga secili prej institucioneve kompetente që zbatojnë një legjislacion, kushtet e të cilit janë plotësuar ;
 - b megjithatë,
 - i nëse i interesuari plotëson kushtet e të paktën dy legjislacioneve, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar periudhave të sigurimit apo të banimit të kryera nën ato legjislacione, kushtet e të

Unofficial, unrevised translation

cilëve nuk plotësohen, këto periudha nuk mbahen parasysh për zbatimin e dispozitave të paragrafëve 2 deri në 4 të nenit 29 ;

- ii nëse i interesuari plotëson kushtet vetëm të një legjislacioni, pa qenë nevoja për t'iu drejtuar dispozitave të nenit 28, shuma e së ardhurës për t'u paguar llogaritet në përputhje vetëm me dispozitat e legjislacionit që i sheh kushtet të plotësuara dhe duke mbajtur parasysh vetëm periudhat e kryera nën këtë legjislacion.
- 2 Të ardhurat që jepen sipas rastit të parashikuar në paragrafin e mësipërm në bazë të një a më shumë legjislacioneve në fjalë rillogariten *ex officio* në përputhje me dispozitat e paragrafëve 2 deri në 4 apo të paragrafit 5 të nenit 29, sipas rastit, me t'u përmbushur kushtet e nevojshme nga një a më shumë legjislacione të tjera në fjalë, duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 28.
 - 3 Të ardhurat që jepen në bazë të legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese rillogariten në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, me kërkesë të të interesuarve, pasi janë përmbushur kushtet e nevojshme që kërkohen nga një apo disa prej këtyre legjislacioneve.

Neni 34

- 1 Nëse shuma e të ardhurave për të cilat mund të pretendojë i interesuari, në bazë të legjislacionit të një Pale kontraktuese, pa zbatim të neneve 28 deri në 33, është më e lartë se shuma e përgjithshme e të ardhurave të llogaritura në përputhje me këto dispozita, institucioni kompetent i kësaj Pale duhet të japë një shtesë plotësuese të barabartë me diferencën midis këtyre dy shumave. Kostoja për këtë shtesë merret tërësisht përsipër nga institucioni në fjalë.
- 2 Në rastin kur zbatimi i dispozitave të paragrafit paraprirës do të sillte për të interesuarin shtesa plotësuese nga ana e institucioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, i interesuari përfiton vetëm shtesën më të lartë. Kostoja e kësaj shtese ndahet midis institucioneve kompetente të Palëve në fjalë, e përpjestuar në bazë të raportit që ekziston midis shtesës që do jepte secila prej tyre po të qe e vetme dhe shumës së përgjithshme të shtesave që do duhej të paguanin të gjitha këto institucione së bashku.

- 3 Shtesa e përmendur në paragrafin paraprirës të këtij neni konsiderohet si komponent i të ardhurave që jep institucioni debitor. Masa e saj përcaktohet njëherë e përgjithnjë, me përjashtim të rastit kur ka vend për zbatim të dispozitave të paragrafit 2 apo të paragrafit 3 të nenit 33.

Nënndarja 2 – Dispozita të veçanta për invaliditetin

Neni 35

- 1 Në rast rëndimi të një invaliditeti për të cilin një person përfiton të ardhura sipas legjislacionit të një Pale të vetme, dispozitat e mëposhtme janë të zbatueshme :
 - a nëse i interesuari, që kur ka përfituar të ardhura, nuk ka qenë objekt i legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i Palës së parë duhet të japë të ardhurat për rëndim invaliditeti, sipas dispozitave të legjislacionit që ai zbaton ;
 - b nëse i interesuari, që kur ka përfituar të ardhura, ka qenë objekt i legjislacionit të një a më shumë Palëve të tjera kontraktuese, të ardhurat i jepen, duke mbajtur parasysh rëndimin, në përputhje me dispozitat e neneve 28 deri në 34 ;
 - c në rastin e përmendur në nënparagrafin e mësipërm, data kur është përcaktuar rëndimi, trajtohet si data për të realizuar këtë mundësi ;
 - d nëse, në rastin e përmendur në nënparagrafin b të këtij paragrafi, i interesuari nuk ka të drejtë për përfitime nga ana e institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, institucioni kompetent i Palës së parë e ka për detyrë t'i japë të ardhurat, duke mbajtur parasysh rëndimin, sipas dispozitave të legjislacionit që ai zbaton.
- 2 Në rast rëndimi të një invaliditeti për të cilin një person përfiton të ardhura sipas legjislacioneve të dy a më shumë Palëve kontraktuese, të ardhurat i jepen, duke mbajtur parasysh rëndimin, në përputhje me dispozitat e neneve 28 deri në 34. Dispozitat e nënparagrafit c të paragrafit të mësipërm janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

Neni 36

- 1 Nëse, pas një pezullimi të të ardhurave, duhet të rifillojë dhënia e tyre, kjo gjë sigurohet nga institucioni apo nga institucionet që bënin pagesën e të ardhurave në çastin e pezullimit të tyre, pa çënuar dispozitat e nenit 37.
- 2 Nëse, pas heqjes të të ardhurave, gjendja e të interesuarit e përligj dhënien e të ardhurave të reja, këto jepen në përputhje me dispozitat e neneve 28 deri në 34.

Neni 37

- 1 Të ardhurat për invaliditet transformohen, në rast nevoje, në të ardhura për pleqëri, në kushtet e parashikuara nga legjislacioni apo nga legjislacionet mbi bazën e të cilave ato janë dhënë dhe në përputhje me dispozitat e neneve 2 deri në 34.
- 2 Kur, në rastin e përmendur në nenin 33, përfituesi i të ardhurave për invaliditet, që janë dhënë në bazë të legjislacionit të një a më shumë Palëve kontraktuese, pranohet të parashtrijë të drejtat për të ardhura për pleqëri, çdo institucion debitor të ardhurash për invaliditet vazhdon ta shërbejë këtë përfitues me të ardhurat që i takojnë, në bazë të legjislacionit që zbaton, deri në çastin kur dispozitat e paragrafit të mësipërm bëhen të zbatueshme ndaj këtij institucioni.

Kreu 3 – Aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale

Neni 38

Unofficial, unrevised translation

- 1 Punonjësit që banojnë në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, viktima të një aksidenti në punë apo të një sëmundjeje profesionale, përfitojnë në territorin e Palës kontraktuese ku banojnë :
 - a të ardhura në natyrë të shërbyera, në ngarkim të institucionit kompetent, nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky i fundit, sikur këta punonjës të qenë të përfshirë në të ;
 - b të ardhura në para të shërbyera nga institucioni kompetent, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton, sikur këta punonjës të banonin në territorin e shtetit kompetent. Megjithatë, pas një ujdje midis institucionit kompetent dhe institucionit të vendbanimit, të ardhurat në para mund të jepen gjithashtu nëpërmjet institucionit të fundit për llogari të institucionit kompetent.
- 2 Të ardhurat mund t'u shërbehen gjithashtu punonjësve kufitarë nëpërmjet institucionit kompetent në territorin e shtetit kompetent, sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, sikur ata të banonin në territorin e tij.
- 3 Nëse punonjës të përmendur në këtë nen, të ndryshëm nga punonjësit kufitarë, banojnë përkohësisht në territorin e shtetit kompetent, ata përfitojnë të ardhura sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, edhe pse kanë përfituar tashmë të ardhura para fillimit të qëndrimit të tyre të përkohshëm.
- 4 Nëse punonjës të përmendur në këtë nen e transferojnë banimin e tyre në territorin e shtetit kompetent, ata përfitojnë të ardhura sipas dispozitave ligjore të këtij shteti, edhe pse kanë përfituar tashmë të ardhura para transferimit të banimit të tyre.

Neni 39

Aksidenti gjatë udhëtimit për në punë që ndodh në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent trajtohet sikur ka ndodhur në territorin e shtetit kompetent.

Neni 40

- 1 Viktimat e një aksidenti në punë apo të një sëmundjeje profesionale,
 - a që banojnë përkohësisht në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, apo
 - b që, pasi janë pranuar për të përfituar të ardhura në ngarkim të institucionit kompetent, autorizohen nga ky institucion të rikthehen në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent ku ato banojnë, apo të transferojnë banimin e tyre në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, apo
 - c që janë lejuar nga institucioni kompetent për të shkuar në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, për të marrë aty përkujdesje për shëndetin e tyre, përfitojnë :
 - i të ardhura në natyrë të shërbyera, në ngarkim të institucionit kompetent, nga institucioni i vendqëndrimit të përkohshëm apo i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton institucioni i fundit, sikur këto viktima të qenë të përfshira në të, brenda kufirit kohor të caktuar, në rast nevojë, nga legjislacioni i shtetit kompetent ;

- ii të ardhura në para të shërbyera nga institucioni kompetent, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton, sikur këto viktima të gjendeshin në territorin e shtetit kompetent. Megjithatë, pas një ujdje midis institucionit kompetent dhe institucionit të vendqëndrimit të përkohshëm apo të vendbanimit, të ardhurat në para mund të jepen gjithashtu nëpërmjet institucionit të fundit për llogari të institucionit kompetent.
- 2 a Autorizimi i përmendur në nënparagrafin b të paragrafit të mësipërm mund të kundërshtohet vetëm nëse zhvendosja e të interesuarit është e një natyre të tillë që rrezikon shëndetin e tij apo zbatimin e një trajtimi mjekësor ;
- b autorizimi i përmendur në nënparagrafin c të paragrafit të mësipërm nuk mund të kundërshtohet kur përkujdesjet për të cilat bëhet fjalë nuk mund t'i bëhen të interesuarit në territorin e Palës kontraktuese ku ai banon.

Neni 41

Në rastet e përmendura në paragrafin 1 të nenit 38 dhe në paragrafin 1 të nenit 40, autoritetet kompetente të dy a më shumë Palëve kontraktuese mund të bien në ujdje që dhënia e protezave, e mjeteve shëndetësore ndihmëse dhe të ardhurave të tjera në natyrë të një rëndësie të veçantë, të bëhet me autorizim të institucionit kompetent.

Neni 42

- 1 Nëse legjisllacioni i shtetit kompetent parashikon marrjen në ngarkim të shpenzimeve të transportit të viktimës, qoftë deri në vendbanimin e tij, qoftë deri në institucionin spitalor, shpenzimet e bëra për transportin e viktimës gjer në vendin korrespondues në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, ku banon viktima, merren në ngarkim nga institucioni kompetent, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton, me kusht që të ketë dhënë më parë autorizimin e tij për këtë transport, në bazë të arsyeve që e përligjin rregullisht.
- 2 Nëse legjisllacioni i shtetit kompetent parashikon marrjen në ngarkim të shpenzimeve të transportit të trupit të viktimës deri në vendin e varrimit, shpenzimet e bëra për transportin e trupit deri në vendin korrespondues në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, ku banonte viktima, merren në ngarkim nga institucioni kompetent, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton.
- 3 Zbatimi i dispozitave të paragrafëve të mësipërm të këtij neni midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe midis këtyre Palëve. Këto marrëveshje do të përcaktojnë konkretisht kategoritë e personave për të cilët dispozita të tilla do të jenë të zbatueshme, si dhe modalitetet e ndarjes së shpenzimeve të transportit midis Palëve kontraktuese në fjalë.

Neni 43

- 1 Nëse në territorin e Palës kontraktuese ku ndodhet viktima nuk ekziston sigurim kundër aksidenteve në punë apo sëmundjeve profesionale, apo nëse një sigurim i tillë ekziston, por nuk përcakton institucion që të përgjigjet për dhënie të ardhurash në natyrë, këto të ardhura jepen nga institucioni i vendqëndrimit të përkohshëm apo i vendbanimit të zakonshëm, që përgjigjet për dhënie të ardhurash në natyrë në rast sëmundjeje.
- 2 Nëse legjisllacioni i shtetit kompetent e sheh faljen e plotë të të ardhurave në natyrë të varur nga zbatimi i shërbimit mjekësor që organizon punëdhënësi, të ardhurat në natyrë të dhëna për rastet që përmenden në paragrafin 1 të nenit 38 dhe në paragrafin 1 të nenit 40, konsiderohen si të dhëna nga një shërbim i tillë mjekësor.
- 3 Nëse legjisllacioni i shtetit kompetent përmban një sistem që ka të bëjë me detyrimet e punëdhënësit, të ardhurat në natyrë të dhëna për rastet që përmenden në paragrafin 1 të nenit 38 dhe në paragrafin 1 të nenit 40 konsiderohen si të dhëna me kërkesën e institucionit kompetent.

- 4 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon në mënyrë të shprehur apo të vetkuptueshme që aksidentet në punë apo sëmundjet profesionale të mëparshme merren parasysh për të vlerësuar shkallën e paaftësisë, institucioni kompetent i kësaj Pale mban gjithashtu parasysh për këtë qëllim aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të njohura më parë nga legjislacioni i çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur ato të kenë ndodhur nën legjislacionin që ai zbaton.

Neni 44

- 1 Nëse legjislacioni që zbaton institucioni i vendqëndrimit apo i vendbanimit përmban shumë sisteme zhdëmtimi, dispozitat e zbatueshme për dhënie të ardhurash në natyrë, për rastet që përmenden në paragrafin 1 të nenit 38 dhe në paragrafin 1 të nenit 40, janë ato të sistemit të përgjithshëm, apo në mungesë, të sistemit prej të cilit varen punonjësit e industrisë.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese përcakton një kohëzgjatje maksimale për dhënie të ardhurash, institucioni që zbaton këtë legjislacion mund të mbajë parasysh, në rast nevoje, periudhën gjatë së cilës janë dhënë tashmë të ardhura nga institucioni i një Pale tjetër kontraktuese për të njëjtin rast aksidenti në punë apo sëmundjeje profesionale.

Neni 45

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave në para mbështetet mbi një fitim mesatar, institucioni kompetent i kësaj Pale e cakton këtë fitim mesatar vetëm në funksion të fitimeve të vërejtura gjatë periudhave të kryera nën këtë legjislacion.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave në para mbështetet mbi një fitim të paracaktuar, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysh vetëm fitimin e paracaktuar apo, në rast nevoje, mesataren e fitimeve të paracaktuara që i përgjigjen periudhave të kryera nën këtë legjislacion.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që shuma e të ardhurave në para ndryshon në funksion të numrit të anëtarëve të familjes, institucioni kompetent i kësaj Pale mban parasysh gjithashtu anëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, sikur këta të banonin në territorin e Palës së parë.

Neni 46

- 1 Kur viktima e një sëmundjeje profesionale ka ushtruar një veprimtari që e shkakton këtë sëmundje nën legjislacionin e një a më shumë Palëve kontraktuese, të ardhurat për të cilat mund të pretendojnë viktima apo pasjetuesit e saj jepen vetëm sipas legjislacionit të Palës më të fundit, kur i plotësojnë kushtet e saj, duke u mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e paragrafëve 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh përfitimin e të ardhurave për sëmundje profesionale të varur nga kushti që sëmundja të jetë konstatuar nga ana mjekësore për herë të parë në territorin e saj, ky kusht njihet i plotësuar kur kjo sëmundje është konstatuar për herë të parë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese, në mënyrë të shprehur apo të vetkuptueshme, e sheh përfitimin e të ardhurave për sëmundje profesionale të varur nga kushti që sëmundja të jetë konstatuar brenda një afati të caktuar pas përfundimit të veprimtarisë së fundit që mund të ketë çuar në një sëmundje të tillë, institucioni kompetent i kësaj Pale, kur shqyrton se në ç'kohë është ushtruar kjo veprimtari e fundit, mban parasysh, për aq sa është e nevojshme, veprimtaritë e së njëjtës natyrë të ushtruara nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur ato të kishin qenë ushtruar nën legjislacionin e Palës së parë.
- 4 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese, në mënyrë të shprehur apo të vetkuptueshme, e sheh përfitimin e të ardhurave për sëmundje profesionale të varur nga kushti që një veprimtari në gjendje për të shkaktuar këtë sëmundje të ketë qenë ushtruar për njëfarë kohe, institucioni kompetent i kësaj

Unofficial, unrevised translation

Pale mban parasysh, për aq sa është e mundur, me qëllim që të arrihet totali, periudhat gjatë së cilës një veprimtari e tillë ka qenë ushtruar nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese.

- 5 Zbatimi i dispozitave të paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni midis dy a më shumë Palëve kontraktuese kushtëzohet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe midis këtyre Palëve. Këto marrëveshje do të përcaktojnë konkretisht sëmundjet profesionale për të cilat dispozita të tilla do të jenë të zbatueshme, si dhe modalitetet për të ndarë koston e të ardhurave midis Palëve kontraktuese në fjalë.

Neni 47

Kur viktima e një sëmundjeje profesionale ka përfituar apo përfiton nga një zhdëmtim në ngarkim të institucionit të një Pale kontraktuese dhe paraqet, në rast rëndimi të sëmundjes, të drejta për të ardhura pranë institucionit të një Pale tjetër kontraktuese, dispozitat e mëposhtme janë të zbatueshme :

- a nëse viktima nuk ka ushtruar nën legjislacionin e Palës së dytë një veprimtari të tillë që të shkaktojë apo të rëndojë sëmundjen, institucioni kompetent i Palës së parë duhet të marrë përsipër koston e të ardhurave, duke pasur parasysh rëndimin e sëmundjes, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton ;
- b nëse viktima ka ushtruar një veprimtari të tillë nën legjislacionin e Palës së dytë, institucioni kompetent i Palës së parë merr përsipër të ardhurat, pa mbajtur parasysh rëndimin, sipas dispozitave ligjore që ai zbaton ; institucioni kompetent i Palës së dytë i jep të interesuarit një shtesë, shuma e së cilës është e barabartë me diferencën midis shumës të të ardhurave që i takon pas rëndimit dhe shumës të të ardhurave që i ka takuar para rëndimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton, sikur sëmundja për të cilën bëhet fjalë të kishte ndodhur nën legjislacionin e kësaj Pale.

Neni 48

- 1 Institucioni kompetent duhet të rimburojë koston e të ardhurave në natyrë shërbyer për llogari të tij në bazë të paragrafit 1 të nenit 38 dhe të paragrafit 1 të nenit 40.
- 2 Rimbursimi i përmendur në paragrafin e mësipërm do të përcaktohet dhe realizohet sipas modaliteteve që u përshtaten autoriteteve kompetente të Palëve kontraktuese.
- 3 Dy a më shumë Palë kontraktuese mund të bien në ujdë për të hequr dorë nga çdo rimbursim mes institucioneve që varen nga kompetencat e tyre.

Kreu 4 – Pagesat në rast vdekjeje**Neni 49**

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për pagesa në rast vdekjeje të varur nga kryerja e periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për arritjen e totalit, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit, me karakter jo kontributiv, të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur të bëhej fjalë për periudha sigurimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për pagesa në rast vdekjeje të varur nga kryerja e periudhave të banimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për arritjen e totalit, periudhat e sigurimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, si dhe, në rast nevojë, periudhat e banimit, me karakter jo kontributiv, të kryera pas moshës gjashtëmbëdhjetë vjeç nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur të bëhej fjalë për periudha banimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.

Neni 50

- 1 Kur një person vdes në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, vdekja konsiderohet sikur ka ndodhur në territorin e shtetit kompetent.
- 2 Institucioni kompetent e ka për detyrë të japë pagesë për vdekje në bazë të legjislacionit që zbaton, qoftë edhe kur përfituesi banon në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent.
- 3 Dispozitat e paragrafëve të mësipërm të këtij neni janë gjithashtu të zbatueshme në rastin kur vdekja shkaktohet nga një aksident në punë apo nga një sëmundje profesionale.

Kreu 5 – Papunësia**Neni 51**

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh arritjen, mbajtjen apo realizimin e së drejtës për të ardhura të varur nga kryerja e periudhave të sigurimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysht për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për arritjen e totalit, periudhat e sigurimit, të punësimit apo të veprimtarisë profesionale të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur të bëhej fjalë për periudha sigurimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë, me kusht që, nëse bëhet fjalë për periudha punësimi apo veprimtarie profesionale, këto periudha të kenë qenë trajtuar më parë si periudha sigurimi po qe se janë kryer nën këtë legjislacion.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh dhënien e të ardhurave të varur nga kryerja e periudhave të punësimit, të veprimtarisë profesionale apo të banimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysht për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për arritjen e totalit, periudhat e sigurimit, të punësimit apo të veprimtarisë profesionale të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur të bëhej fjalë për periudha punësimi, veprimtarie profesionale apo banimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.
- 3 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh dhënien e disa të ardhurave të varur nga kushti që periudhat e sigurimit të jenë kryer në një profesion të tillë që i përgjigjet një sistemi të veçantë, periudhat e kryera nën legjislacionet e Palëve të tjera kontraktuese merren parasysht për dhënien e këtyre të ardhurave vetëm po qe se ato janë kryer brenda një sistemi korrespondues apo, në mungesë, brenda të njëjtë profesion. Nëse, nisur nga periudhat e kryera në këtë mënyrë, i interesuari nuk i plotëson kushtet e duhura për të përfituar të ardhura të tilla, këto periudha merren parasysht për dhënie të ardhurash brenda sistemit të përgjithshëm.
- 4 Zbatimi i dispozitave të paragrafëve të mësipërm të këtij neni varet nga kushti që i interesuari të ketë qenë së fundi objekt i legjislacionit të Palës kontraktuese mbi bazën e të cilit kërkohen të ardhurat, me përjashtim të rasteve të përmendura në nënparagrafët a. ii dhe b. ii të paragrafit 1 të nenit 53.

Neni 52

Të papunët që plotësojnë kushtet e kërkuara nga legjislacioni i një Pale kontraktuese lidhur me të drejtën për të ardhura, për sa i përket zbatimit të periudhave të sigurimit, të punësimit, të veprimtarisë profesionale apo të banimit, nisur, në rast nevojë, nga dispozitat e nenit 51, dhe që e transferojnë banimin e tyre në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, duhet të plotësojnë gjithashtu kushtet e kërkuara në këtë drejtim nga legjislacioni i Palës së dytë për të patur të drejtë për të ardhura, si dhe t'i paraqesin një kërkesë institucionit të vendbanimit të tyre të ri brenda një afati prej tridhjetë ditësh pas transferimit të tyre. Të ardhurat jepen nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky institucion, në ngarkim të institucionit kompetent të Palës së parë.

Neni 53

Unofficial, unrevised translation

-
- 1 Pa cënuar dispozitat e nenit 52, një i papunë, i cili gjatë periudhës së tij të fundit të punësimit banonte në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, përfiton të ardhura sipas dispozitave të mëposhtme :
- a
 - i një punonjës kufitar, në papunësi të pjesshme, përfiton të ardhura sipas dispozitave ligjore të shtetit kompetent, sikur të banonte në territorin e këtij shteti, duke pasur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 51 ; këto të ardhura jepen nga institucioni kompetent ;
 - ii një punonjës kufitar, në papunësi të plotë, përfiton të ardhura sipas dispozitave ligjore të Palës kontraktuese në territorin e së cilës ai banon, sikur të kishte qenë objekt i këtij legjislacioni gjatë periudhës së tij të fundit të punësimit, duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 51 ; këto të ardhura jepen nga institucioni i vendbanimit ;
 - b
 - i një punonjës, i ndryshëm nga punonjësi kufitar, në papunësi të pjesshme, të rastësishme apo të plotë, që mbetet në dispozicion të punëdhënësit të tij apo të zyrave të punësimit në territorin e shtetit kompetent, përfiton të ardhura sipas dispozitave ligjore të shtetit kompetent, sikur të banonte në territorin e këtij shteti, duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 51 ; këto të ardhura jepen nga institucioni kompetent ;
 - ii një punonjës, i ndryshëm nga punonjësi kufitar, në papunësi të plotë, që vihet në dispozicion të zyrave të punësimit në territorin e një Pale kontraktuese ku ai banon apo ku rikthehet, përfiton të ardhura sipas dispozitave të legjislacionit të këtij shteti, sikur të ishte objekt i këtij legjislacioni gjatë punësimit të tij të fundit, duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e nenit 51 ; këto të ardhura jepen nga institucioni i vendbanimit ;
 - iii megjithatë, nëse punonjësi i përmendur në nënparagrafin b.ii të këtij paragrafi, ka qenë pranuar për të përfituar të ardhura nga institucioni kompetent i Palës kontraktuese, në legjislacionin e së cilës ka qenë së fundi objekt trajtimi, ai përfiton të ardhura në përputhje me dispozitat e nenit 52, sikur të kish bërë transferim të banimit të tij në territorin e Palës kontraktuese të përmendur në nënparagrafin b.ii të këtij paragrafi.
- 2 Për aq kohë sa një i papunë ka të drejtë për të ardhura sipas nënparagrafit a.i apo sipas nënparagrafit b.i të paragrafit paraprirës, ai nuk mund të pretendojë për të ardhura në bazë të legjislacionit të Palës kontraktuese në territorin e së cilës banon.

Neni 54

Në rastet e përmendura në nenin 52 dhe në nënparagrafin b.iii të paragrafit 1 të nenit 53, nëse legjislacioni që zbaton institucioni i vendbanimit cakton një kohë maksimale për dhënie të ardhurash, ky institucion mund të mbajë parasysh, në rast nevoje, periudhën gjatë së cilës janë dhënë tashmë të ardhura nga institucioni i një Pale tjetër kontraktuese pas përcaktimit të fundit të së drejtës për të ardhura.

Neni 55

- 1 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që llogaritja e të ardhurave mbështetet mbi shumën e fitimit të mëparshëm, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh vetëm fitimin e marrë nga i interesuari për veprimtarinë e fundit që ai ka ushtruar në territorin e Palës në fjalë apo, nëse i interesuari nuk e ka ushtruar veprimtarinë e tij të fundit të paktën katër javë në këtë territor, fitimin e zakonshëm që i përgjigjet, në vendin ku banon i papuni, një veprimtarie të barasvlefshme apo të përngjashme me atë që ai ka ushtruar së fundi në territorin e një Pale tjetër kontraktuese.
- 2 Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese parashikon që shuma e të ardhurave është në funksion të numrit të pjesëtarëve të familjes, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysh gjithashtu pjesëtarët e familjes që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, sikur të banonin në territorin e Palës së parë.
- 3 Nëse legjislacioni që zbaton institucioni i vendbanimit parashikon që kohëzgjatja e dhënies të të ardhurave varet nga kohëzgjatja e periudhave të kryera, kohëzgjatja për dhënie të ardhurash përcaktohet duke mbajtur parasysh, në rast nevoje, dispozitat e paragrafit 1 apo dispozitat e paragrafit 2 të nenit 51.

Neni 56

- 1 Zbatimi i dispozitave të neneve 52 deri në 54 midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe e shumëpalëshe midis këtyre Palëve, të cilat mund të parashikojnë nga ana tjetër modalitete të veçanta përkatëse.
- 2 Marrëveshjet e përmendura në paragrafin e mësipërm do të përcaktojnë konkretisht :
 - a kategoritë e personave për të cilët do të jenë të zbatueshme dispozitat e neneve 52 deri në 54;
 - b kohën gjatë së cilës mund të jepen të ardhurat nga ana e institucionit të një Pale kontraktuese për llogari të institucionit të një Pale tjetër kontraktuese ;
 - c modalitetet e rimbursimit të të ardhurave të dhëna nga institucioni i një Pale kontraktuese për llogari të institucionit të një Pale tjetër kontraktuese.
- 3 Dy a më shumë Pale kontraktuese mund të merren vesh për të hequr dorë nga çdo rimbursim mes institucioneve që varen nga kompetencat e tyre.

Kreu 6 – Të ardhura për familje**Neni 57**

Nëse legjislacioni i një Pale kontraktuese e sheh të drejtën për të ardhura të varur nga kryerja e periudhave të punësimit, të veprimtarisë profesionale apo të banimit, institucioni që zbaton këtë legjislacion mban parasysht për këtë qëllim, për aq sa është e mundur, për të arritur totalin, periudhat e punësimit, të veprimtarisë profesionale apo të banimit të kryera nën legjislacionin e çdo Pale tjetër kontraktuese, sikur të bëhej fjalë për periudha punësimi, veprimtarie profesionale apo banimi të kryera nën legjislacionin e Palës së parë.

Neni 58

- 1 Zbatimi i dispozitave të nënndarjes 1 apo të nënndarjes 2 të këtij kreu midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga përfundimi i marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe mes këtyre Palëve, të cilat mund të parashikojnë nga ana tjetër modalitete të veçanta përkatëse.
- 2 Marrëveshjet e përmendura në paragrafin e mësipërm do të përcaktojnë konkretisht :
 - a kategoritë e personave për të cilët do të jenë të zbatueshme dispozitat e neneve 59 deri në 62;
 - b rregullat për të shmangur mbledhje të ardhurash të së njëjtës natyrë ;
 - c ruajtjen e të drejtave të arritura, në rast nevoje, në bazë të konventave të sigurimeve shoqërore.

Nënndarja 1 – Pagesat për familje**Neni 59**

- 1 Për zbatimin e këtij neni dhe të nenit 60, termi « fëmijë » përcakton, në kufijtë e njohur nga legjislacioni i Palës kontraktuese në fjalë :
 - a fëmijët e ligjshëm, të ligjëruar, të pranuar si të lindur jashtë martese, të adoptuar si dhe nipërit e mbesat jetimë të përfituesit ;
 - b fëmijët e ligjshëm, të ligjëruar, të pranuar si të lindur jashtë martese, të adoptuar si dhe nipërit e mbesat jetimë të bashkëshortit përfitues, me kusht që të jetojnë në shtëpinë e këtij të fundit dhe të banojnë në territorin e një Pale kontraktuese.
- 2 Personat që janë objekt i legjislacionit të një Pale kontraktuese, dhe që kanë fëmijë që banojnë apo rriten në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, kanë të drejtë të marrin për këta fëmijë pagesë për familje sipas legjislacionit që parashikon Pala e parë, sikur këta fëmijë të banonin apo të rriteshin në territorin e kësaj Pale.
- 3 Megjithatë, në rastin e përmendur në paragrafin paraprirës, shuma e pagesave për familje mund të kufizohet deri në masën kur arrin pagesat për familje të parashikuara nga legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës fëmijët banojnë apo rriten.

Unofficial, unrevised translation

- 4 Në rastin e zbatimit të dispozitave të paragrafit të mësipërm, krahasimi i shumave të pagesave për familje sipas dy legjislacioneve përkatëse realizohet duke mbajtur parasysh numrin e përgjithshëm të fëmijëve që varen nga i njëjti përfitues. Nëse legjislacioni i Palës kontraktuese në territorin e së cilës fëmijët banojnë apo rriten parashikon shuma të ndryshme pagese për familje sipas kategorive të ndryshme të përfituesve, në këtë rast, mbahen parasysh shumat që do jepeshin, sikur personi të ishte objekt i këtij legjislacioni.
- 5 Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni nuk janë të zbatueshme për një punonjës me pagë parashikuar në nënparagrafin a të paragrafit 1 të nenit 15, lidhur me fëmijët që e shoqërojnë në territorin e Palës kontraktuese ku ai është vendosur.
- 6 Pagesat për familje jepen sipas dispozitave ligjore të Palës kontraktuese që ka për objekt përfituesin, edhe pse personi fizik apo moral të cilit duhet t'i jepen këto pagesa banon apo ndodhet në territorin e një Pale tjetër kontraktuese.

Neni 60

- 1 Të papunët që përfitojnë të ardhura për papunësi në ngarkim të institucionit të një Pale kontraktuese, dhe që kanë fëmijë që banojnë apo rriten në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, kanë të drejtë të marrin për këta fëmijë pagesa për familje të parashikuara në këtë rast nga legjislacioni i Palës së parë, sikur këta fëmijë të banonin apo të rriteshin në territorin e kësaj Pale.
- 2 Në rastin e përmendur në paragrafin paraprirës, dispozitat e paragrafëve 1, 3, 4 dhe 6 të nenit 59 janë të zbatueshme *mutatis mutandis*.

Nënndarja 2 – Të ardhura për familje**Neni 61**

- 1 Personat që janë objekt i një Pale kontraktuese kanë të drejtë, për anëtarët e familjes së tyre që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, për të ardhura të parashikuara nga legjislacioni i kësaj Pale të fundit, sikur personat në fjalë të ishin objekt i legjislacionit të saj. Këto të ardhura u jepen anëtarëve të familjeve nga institucioni i vendbanimit të tyre, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky institucion, në ngarkim të institucionit kompetent.
- 2 Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit të mësipërm, një punonjës me pagë parashikuar në nënparagrafin a të paragrafit 1 të nenit 15 ka të drejtë, për anëtarët e familjes së tij që e shoqërojnë në territorin e Palës kontraktuese ku ai është vendosur, për të ardhura që parashikon legjislacioni i Palës kontraktuese, objekt i të cilit ai vazhdon të mbetet. Këto të ardhura jepen nga institucioni kompetent i kësaj Pale të fundit. Megjithatë, pas një marrëveshjeje midis institucionit kompetent dhe institucionit të vendbanimit, të ardhurat mund të jepen gjithashtu nëpërmjet këtij institucioni të fundit për llogari të institucionit kompetent.

Neni 62

Të papunët që përfitojnë të ardhura për papunësi në ngarkim të institucionit të një Pale kontraktuese kanë të drejtë, për anëtarët e familjes së tyre që banojnë në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, për të ardhura për familje të parashikuara nga legjislacioni i kësaj Pale të fundit, me kusht që legjislacioni i Palës së parë të japë të ardhura për familje në rast papunësie. Të ardhurat për familje u jepen anëtarëve të familjes nga institucioni i vendbanimit, sipas dispozitave ligjore që zbaton ky institucion, në ngarkim të institucionit kompetent të Palës së parë.

Neni 63

- 1 Në rast zbatimi të dispozitave të kësaj nënndarjeje midis dy a më shumë Palëve kontraktuese, marrëveshjet dypalëshe a shumëpalëshe të parashikuara në paragrafin 1 të nenit 58 do të përcaktojnë kushtet e rimbursimit të të ardhurave të dhëna nga institucioni i një Pale në ngarkim të institucionit të një Pale tjetër kontraktuese.
- 2 Dy a më shumë Palë kontraktuese mund të bien në ujdë për të hequr dorë nga çdo rimbursim mes institucioneve që varen nga kompetencat e tyre.

Pjesa IV – Dispozita të ndryshme**Neni 64**

- 1 Autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese i përcjellin shoshëqit :
 - a të gjitha informacionet lidhur me masat e marra për zbatimin e kësaj Konvente ;
 - b të gjitha informacionet lidhur me ndryshimet në legjislacionin e tyre që mund të prekin zbatimin e kësaj Konvente.
- 2 Për zbatimin e kësaj Konvente, autoritetet dhe institucionet e Palëve kontraktuese nuk kursejnë ndihmesën e tyre, sikur të bëhej fjalë për zbatimin e vetë legjislacionit të tyre. Ndihma e ndërsjellë administrative e këtyre autoriteteve dhe institucioneve në parim është falas. Megjithatë, autoritetet kompetente të Palëve kontraktuese mund të bien në ujdë për rimbursimin e disa veprimeve nga ana e tyre.
- 3 Për zbatimin e kësaj Konvente, autoritetet dhe institucionet e Palëve kontraktuese mund të komunikojnë drejtpërdrejt midis tyre, si dhe me të interesuarit apo mandatuesit e tyre.
- 4 Autoritetet, institucionet dhe juridiksionet e një Pale kontraktuese nuk mund të hedhin poshtë kërkesat apo dokumentet e tjera që u drejtohen, për faktin se janë hartuar në një gjuhë zyrtare të një Pale tjetër kontraktuese.

Neni 65

- 1 Përfitimi nëpërmjet përjashtimeve ose pakësimeve të taksave, pullave taksë, të të drejtave sekretariale apo regjistruese parashikuar nga legjislacioni i një Pale kontraktuese për shkresa a dokumente të nxjerra në zbatim të legjislacionit të kësaj Pale, shtrihet edhe për shkresa a dokumente të ngjashme të nxjerra në zbatim të legjislacionit të një Pale tjetër kontraktuese apo të kësaj Konvente.
- 2 Të gjitha aktet, dokumentet apo shkresat zyrtare të çfarëdoshme që nxirren për qëllimet e zbatimit të kësaj Konvente përjashtohen nga legalizimi apo çdo formalitet tjetër i ngjashëm.

Neni 66

- 1 Nëse kërkuesi banon në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, ai mund t'ia paraqesë vlefshmërisht kërkesën e vet institucionit të vendbanimit, i cili i drejtohet institucionit apo institucioneve kompetente të përmendura në kërkesë.

- 2 Kërkesat, deklaratat apo rekurset që duhej të bëheshin, sipas legjislacionit të një Pale kontraktuese, brenda një afati të caktuar, pranë një autoriteti, institucioni apo juridiksioni të kësaj Pale, janë të pranueshme nëse bëhen brenda të njëjtit afat pranë një autoriteti, institucioni apo juridiksioni të një Pale tjetër kontraktuese. Në këtë rast, autoriteti, institucioni apo juridiksioni i kësaj Pale i përcjell pa vonesë këto kërkesa, deklaratat apo rekurse tek autoriteti, institucioni apo juridiksioni kompetent i Palës së parë, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet autoriteteve kompetente të Palëve kontraktuese në fjalë. Data kur këto kërkesa, deklaratat apo rekurse janë marrë nga ana e një autoriteti, institucioni apo juridiksioni të Palës së dytë konsiderohet si data kur i janë paraqitur autoritetit, institucionit apo juridiksionit kompetent për t'u njohur me to.

Neni 67

- 1 Ekspertizat mjekësore të parashikuara nga legjislacioni i një Pale kontraktuese, me kërkesë të institucionit që zbaton këtë legjislacion, mund të kryen në territorin e një Pale tjetër kontraktuese nga institucioni i vendbanimit të zakonshëm apo i vendqëndrimit të përkohshëm. Në këtë rast, ato konsiderohen si të kryera në territorin e Palës së parë.
- 2 Zbatimi i dispozitave të paragrafit të mësipërm midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe mes këtyre Palëve.

Neni 68

- 1 Kur, në bazë të kësaj Konvente, institucioni i një Pale kontraktuese është i detyruar t'i paguajë të ardhura në para një përfituesi që ndodhet në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, detyrimi shprehet në monedhën e Palës së parë. Institucioni në fjalë e shlyen detyrimin në mënyrë të vlefshme në monedhën e Palës së dytë.
- 2 Kur, në bazë të kësaj Konvente, institucioni i Palës kontraktuese është i detyruar të paguajë shuma për rimbursim të të ardhurave që ka dhënë institucioni i një Pale tjetër kontraktuese, detyrimi shprehet në monedhën e Palës së dytë. Institucioni i parë e shlyen detyrimin në mënyrë të vlefshme në atë monedhë, me përjashtim të rastit kur Palët kontraktuese në fjalë kanë rënë në ujdi për modalitete të tjera.
- 3 Transferrat e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj Konvente kryen në përputhje me marrëveshjet në fuqi në këtë fushë, në çastin e transfertës, midis Palëve kontraktuese në fjalë. Në mungesë, përcaktohen masat e nevojshme për kryerjen e këtyre transfertave me marrëveshje të përbashkët midis Palëve.

Neni 69

- 1 Për të përcaktuar masën e kontributeve ndaj një institucioni të një Pale kontraktuese, mbahen parasysh, në rast nevoje, të ardhurat që merren në territorin e çdo Pale tjetër kontraktuese.
- 2 Vjelja e kontributeve që i takojnë institucionit të një Pale kontraktuese mund të bëhet në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, në përputhje me procedurën administrative dhe garancitë e privilegjet që zbatohen për vjeljen e kontributeve për një institucion korrespondues të kësaj Pale të fundit.
- 3 Zbatimi i dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe midis këtyre Palëve. Këto marrëveshje mund të realizohen gjithashtu lidhur me procedurën juridike të vjeljes së kontributeve.

Neni 70

- 1 Nëse një person përfiton të ardhura sipas legjislacionit të një Pale kontraktuese për dëmtim të shkaktuar a të ndodhur në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, të drejtat e institucionit që paguan të ardhurat, lidhur me një palë të tretë që paguan dëmin, rregullohen si më poshtë :
 - a kur institucioni në fjalë, sipas legjislacionit që zbaton, është i zëvendësuar në të drejtat që ka përfituesi ndaj palës së tretë, një zëvendësim i tillë njihet nga çdo Palë tjetër kontraktuese ;
 - b kur institucioni në fjalë ka një të drejtë të drejtëpërdrejtë ndaj një pale të tretë, çdo Palë kontraktuese e njeh këtë të drejtë.
- 2 Zbatimi i dispozitave të paragrafit të mësipërm midis dy a më shumë Palëve kontraktuese varet nga arritja e marrëveshjeve dypalëshe a shumëpalëshe midis këtyre Palëve
- 3 Rregullat e zbatueshme lidhur me përgjegjësinë e punëdhënësit a të personave që veprojnë në emër të tij, për rastet e aksidentit në punë apo gjatë udhëtimit për në punë kur ndodhin në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga shteti kompetent, do të vendosen me anë marrëveshjesh midis Palëve kontraktuese të interesuara.

Neni 71

- 1 Çdo mosmarrëveshje që mund të ndodhë midis dy a më shumë Palëve kontraktuese lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj Konvente do të jetë fillimisht objekt bisedimesh midis Palëve në mosmarrëveshje.
- 2 Nëse njëra nga Palët në mosmarrëveshje është e mendimit se çështja në fjalë i intereson tërë Palëve kontraktuese, Palët në konflikt, me marrëveshje të përbashkët, apo në mungesë, njëra prej tyre, i drejtohen në këtë rast Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili parashtron gjykimin e tij të shkruar për çështjen në fjalë brenda një afati prej gjashtë muajsh.

Unofficial, unrevised translation

- 3 Nëse mosmarrëveshja nuk arrin të zgjidhet, sipas rastit, qoftë brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës së parë për çelje të bisedimeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, qoftë brenda tre muajve nga data kur Komiteti i Ministrave u ka komunikuar Palëve kontraktuese gjykimin e vet, mosmarrëveshja mund të përbëjë objektin e një procedure arbitrore para një gjykatësi të vetëm me kërkesë të çdo Pale në konflikt. Pala kërkuese e njofton Palën tjetër, nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, për objektin e kërkesës që ajo ka ndër mend t'ia parashtrojë arbitrazhit, si dhe për mjetet mbi të cilat mbështetet kjo kërkesë.
- 4 Me përjashtim të rastit kur Palët në konflikt bien ndryshe në ujdi, arbitri do të caktohet nga Kryetari i Gjykatës evropiane të të Drejtave të Njeriut. Arbitri nuk duhet të jetë qytetar i një Pale në konflikt, as ta ketë vendbanimin e tij të zakonshëm në territorin e njëres prej këtyre Palëve, as të ndodhet në shërbim të tyre, as edhe të jetë marrë më parë me çështjen nën ndonjë cilësi tjetër.
- 5 Nëse, lidhur me rastin e përmendur në paragrafin e mësipërm, Kryetari i Gjykatës evropiane të të Drejtave të Njeriut e ka të ndaluar të veprojë apo nëse ai është shtetas i një Pale në konflikt, caktimi i arbitrit i takon në këtë rast Nën-Kryetarit të Gjykatës apo anëtarit më të vjetër të Gjykatës që nuk e ka të ndaluar dhe që nuk është shtetas i një prej Palëve në konflikt.
- 6 Në mungesë të një kompromisi të veçantë midis Palëve në konflikt, apo në mungesë qartësimesh të mjaftueshme për kompromis, arbitri do të vendosë në bazë të dispozitave të kësaj Konvente, duke mbajtur parasysh parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.
- 7 Vendimi i arbitrit do të jetë i detyrueshëm dhe pa apelim.

Neni 72

- 1 Shtojca VII përmend për çdo Palë kontraktuese të interesuar modalitetet e veçanta zbatuese të legjislacionit të saj.
- 2 Çdo Palë kontraktuese e interesuar do të notifikojë, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 81, çdo amendament që do t'i bëjë shtojcës VII. Nëse ky amendament vjen si pasojë e miratimit të një legjislacioni të ri, notifikimi do të bëhet brenda tre muajve nga data e shpalljes së legjislacionit në fjalë apo, nëse ky legjislacion është shpallur para datës së ratifikimit të kësaj Konvente, ditën e këtij ratifikimi.

Neni 73

- 1 Shtojcat e përmendura në nënparagrafin b të nenit 1, në paragrafin 1 të nenit 3, në paragrafin 3 të nenit 6, në paragrafin 4 të nenit 8, në paragrafin 2 të nenit 9, në paragrafin 3 të nenit 11 dhe në paragrafin 1 të nenit 72, si dhe amendamentet që do t'u bëhen këtyre shtojcave, janë pjesë përbërëse e kësaj Konvente.
- 2 Çdo amendament për shtojcat e përmendura në paragrafin e mëparshëm do të konsiderohet si i miratuar nëse, brenda tre muajve pas notifikimit të parashikuar në nënparagrafin d të paragrafit 2 të nenit 81 të kësaj Konvente, asnjëra nga Palët kontraktuese apo asnjë shtet nënshkruar nuk i është kundërvënë me anë notifikimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 3 Në rast notifikimi të një kundërshtimi të tillë te Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës, çështja do të shtrohet për zgjidhje sipas një procedure që do të vendosë Komiteti i Ministrave.

Pjesa V – Dispozita kalimtare e përfundimtare**Neni 74**

- 1 Kjo Konventë nuk sjell asnjë të drejtë për një periudhë para hyrjes së saj në fuqi ndaj Palës kontraktuese apo Palëve kontraktuese në fjalë.
- 2 Çdo periudhë sigurimi, si dhe, në rast nevoje, çdo periudhë punësimi, veprimtarie profesionale apo banimi, e kryer nën legjislacionin e një Pale kontraktuese para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente merret në konsideratë lidhur me përcaktimin e të drejtave që lindin në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente.
- 3 Në vartësi të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, një e drejtë mund të lindë, në bazë të kësaj Konvente, edhe nëse ajo ka të bëjë me një rast që ka ndodhur para hyrjes së saj në fuqi.
- 4 Çdo e ardhur që nuk është shlyer apo që ka qenë pezulluar për shkak të kombësisë së personit apo për shkak të vendbanimit të tij në territorin e një Pale kontraktuese e ndryshme nga ajo ku ndodhet institucioni që jep të ardhurën, me kërkesë të të interesuarit, do të shlyhet apo do të rivendoset me të hyrë në fuqi kjo Konventë, me përjashtim të rastit kur të drejtat e parashikuara janë shlyer më parë nëpërmjet një zgjidhjeje në para.
- 5 Të drejtat e të interesuarve që janë shlyer, para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, për një pension apo rentë, do të rishikohen me kërkesë të tyre, duke mbajtur parasysh dispozitat e kësaj Konvente. Këto të drejta mund të rishikohen gjithashtu *ex officio*. Në asnjë rast, një rishikim i tillë nuk duhet të sjellë për rezultat pakësimin e të drejtave të mëparshme të të interesuarve.
- 6 Nëse kërkesa e përmendur në paragrafin 4 apo kërkesa e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni paraqitet brenda dy vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, të drejtat që lindin sipas dispozitave të kësaj Konvente pranohen duke filluar nga kjo datë, dhe në këtë rast, dispozitat ligjore të çdo Pale kontraktuese, lidhur me humbjen apo parashkrimin e të drejtave për shkak të përfundimit të afatit të tyre, nuk ka pse t'u kundërvihen të interesuarve.
- 7 Nëse kërkesa e përmendur në paragrafin 4 apo kërkesa e përmendur në paragrafin 5 të këtij neni paraqitet pas mbarimit të një afati prej dy vjetësh që pason hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, të drejtat që nuk janë parashikuar me humbje afati apo me parashkrim afati fitohen vetëm duke mbajtur parasysh datën e kërkesës, në vartësi të dispozitave ligjore më të favorshme të legjislacionit të Palës kontraktuese në fjalë.

Neni 75

- 1 Kjo Konventë është e hapur për nënshkrimin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Ajo do të ratifikohet apo pranohet. Instrumentat e ratifikimit apo pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 2 Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të tretë që pason ditën kur është bërë depozitimi i instrumentit të tretë të ratifikimit apo pranimit.
- 3 Ajo do të hyjë në fuqi, ndaj çdo shteti nënshkrues që më pas do ta ratifikojë a pranojë atë, tre muaj nga dita e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit a pranimit.

Neni 76

Me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, dispozitat e Marrëveshjes së përkohëshme evropiane lidhur me sigurimet shoqërore, pa sistemet që kanë të bëjnë me pleqërinë, invaliditetin dhe personat pasjetues, dhe të Marrëveshjes së përkohëshme evropiane lidhur me sistemet e sigurimeve shoqërore për pleqërinë, invaliditetin dhe personat pasjetues, si dhe të Protokolleve të tyre shtesë, nuk zbatohen më në marrëdhëniet midis Palëve kontraktuese.

Neni 77

- 1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës mund të ftojë çdo shtet joanëtar të Këshillit të aderojë në këtë Konventë. Rezoluta lidhur me këtë ftesë duhet të marrë miratimin e njëzëshëm të shteteve anëtare të Këshillit që kanë ratifikuar apo pranuar Konventën në fjalë.
- 2 Aderimi do të kryet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës të një instrumenti aderues që do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të tij.

Neni 78

- 1 Kjo Konventë do të mbetet në fuqi pa kufizim kohe.
- 2 Çdo Palë kontraktuese, për aq sa i takon, pas pesë vjetësh që kjo Konventë ka hyrë në fuqi për të, mund ta denoncojë këtë Konventë duke i drejtuar një notifikim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 3 Denoncimi hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës kur merr notifikimin Sekretari i Përgjithshëm.

Neni 79

- 1 Në rast denoncimi të kësaj Konvente, çdo e drejtë që është arritur në bazë të dispozitave të saj, ruhet.
- 2 Të drejtat që janë duke u fituar lidhur me periudhat e kryera para datës së hyrjes në fuqi të denoncimit, nuk shuhet për shkak të këtij denoncimi; ruajtja e tyre e mëpasshme përcaktohet me anë marrëveshjeje, apo në mungesë të një marrëveshjeje të tillë, nëpërmjet legjislacionit që zbaton institucioni në fjalë.

Neni 80

- 1 Zbatimi i kësaj Konvente do të arrihet nëpërmjet dispozitave të një Marrëveshjeje plotësuese, që është e hapur për nënshkrimin e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.
- 2 Palët kontraktuese apo, nëse dispozitat kushtetuese të këtyre Palëve e lejojnë, autoritetet e tyre kompetente, do të bëjnë çdo rregullim tjetër të nevojshëm për zbatimin e kësaj Konvente.
- 3 Çdo shtet nënshkrues i kësaj Konvente që e ratifikon apo e pranon atë, duhet ose të ratifikojë a të pranojë në të njëjtën kohë edhe Marrëveshjen plotësuese, ose ta nënshkruajë Marrëveshjen plotësuese në fjalë pa rezervë ratifikimi apo pranimi, jo më vonë nga koha e depozitimit të instrumentit të vet të ratifikimit apo të pranimi të Konventës.

- 4 Çdo shtet që aderon në këtë Konventë duhet në të njëjtën kohë të aderojë edhe në Marrëveshjen plotësuese.
- 5 Çdo Palë kontraktuese që e denoncon këtë Konventë duhet në të njëjtën kohë të denoncojë edhe Marrëveshjen plotësuese.

Neni 81

- 1 Notifikimet apo deklaramet e përmendura në nënparagrafët b dhe w të nenit 1, në paragrafin 2 të nenit 3, në paragrafin 5 të nenit 6, në paragrafin 2 të nenit 7, në paragrafin 5 të nenit 8, në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 9, në paragrafin 4 të nenit 11 dhe në paragrafin 2 të nenit 72 i drejtohen Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.
- 2 Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do të notifikojë, brenda një muaji, tek Palët kontraktuese të shteteve nënshkruese si dhe tek Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Ndërkombëtare të Punës :
 - a çdo nënshkrim, si dhe depozitimin e çdo instrumenti të ratifikimit, pranimit apo aderimit ;
 - b çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me dispozitat e nenit 57 dhe të nenit 77 ;
 - c çdo notifikim denoncimi të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 78 dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi ;
 - d çdo notifikim apo deklaramet të marrë në zbatim të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni.

Për të dëshmuar këtë, të nënshkruarit, rregullisht të autorizuar për këtë qëllim, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Paris, më 14 dhjetor 1972, në frëngjisht dhe në anglisht, ku të dy tekstet janë njëlloj të vërtetë, në një kopje të vetme që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Evropës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës do t'i transmetojë kopje të vërtetuar secilit prej shteteve nënshkruese dhe aderuese.

SHTOJCA I

(Neni 1 nënparagrafi b)

Përcaktimi i territoreve dhe i shtetasve të Palëve kontraktuese

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA II

(Neni 3, paragrafi 1)

Legjislacione dhe sisteme në të cilat zbatohet kjo Konventë

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA III

(Neni 6, paragrafi 3)

Dispozita të mbajtura në fuqi pavarësisht nga dispozitat e nenit 5

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA IV

(Neni 8, paragrafi 4)

Të ardhura për të cilat dispozitat e paragrafit 2 apo të paragrafit 3 të nenit 8 janë të zbatueshme

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA V

(Neni 9, paragrafët 2 dhe 3)

Dispozita, përfitimi i të cilave shtrihet tek shtetasit e të gjitha Palëve kontraktuese

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA VI

(Neni 11, paragrafi 3)

Të ardhura për të cilat dispozitat e paragrafit 1 apo të paragrafit 2 të nenit 11 nuk janë të zbatueshme

(Teksti nuk është dhënë)

SHTOJCA VII

(Neni 72, paragrafi 1)

Modalitete të veçanta për zbatimin e legjislacioneve të Palëve kontraktuese

(Teksti nuk është dhënë)